Matesi duhet të ketë mundësi për matjen, ruajtjen dhe shfaqjen e fuqisë aktive mesatare maksimale të importuar (që ka kaluar në mates) sipas planit të tarifor brenda klases së saktësisë (treguesi i regjistrimit 1.6.x sipas EN 62056-61 (OBIS)).

#### **Fuqia e castit**

Matesi duhet të ketë mundësi për matjen dhe shfaqjen e fuqisë së castit.

#### **Tension i castit**

Matesi duhet te kete mundesine per matjen dhe shfaqjen e tensionit te castit per secilen faze.

#### **Rryma e castit**

Matesit duhet te kene mundesine per matjen dhe shfaqjen e rrymes se castit per secilen faze.

#### **Frekuenca e castit**

Matesit duhet te kene mundesine per matjen dhe shfaqjen e frekuences se castit.

#### **Vlera maksimale e rrymes**

Matesi duhet te kete mundesine per matjen, ruajtjen dhe shfaqjen e vleres se rrymes maksimale te fazave ne nivel mujor.

#### **Mungesa e fazes se tensionit**

Matesi duhet te kete mundesine per regjistrimin e mungeses se tensionit fazor ne nje nga terminalet. Mungesa e secilit tension fazor eshte e treguar ne ekran duke larguar shenjat L1, L2, L3 kur tensioni eshte me pak se 50% e vleres nominale.

Matesit gjithashtu mund te konfigurohen per te aktivizuar nje alarm nese nje faze mungon.

#### **Ora e brendeshme**

**Ora e brendeshme ne kohe reale jep te gjitha sinjalet e nevojshme per punimin e matesit ne lidhje me treguesin maksimal te kerkeses**, menaxhimi i tarifes dhe regjistrime te tjera. Ora e brendeshme duhet te mbaje kohen e sakte dhe daten ne rastin e mungeses se energjise per dy vjet. Ora duhet automatikisht te pershtatet me oren zyrtare.

Ora e brendeshme e matesit duhet te permbushe kerkesat e treguar ne normen CEI EN62054-21 per komutatoret orare dhe IEC 62052-21.

#### **Bateria**

Bateria ka 10 vjet kapacitet dhe jetegjatesia mbi 10 vjet, Bateria eshte vendosur poshte mbuleses se bllokut te terminalit te matesit dhe eshte e arritshme pa levizur vulen e cila mbron pjeset matese te matesit.

#### **Menaxhimi tarifor**

Matesi duhet te kete mundesi per dy lloje menaxhimi tarifor. Burimi i ndryshimit te tarifes mund te jete plan i tarifes se brendeshme dhe te jashtme.

Lloji i menaxhimit te tarifave eshte i programueshem.

#### **Mbrojtja e integritetit te matjes**

Matesi duhet te kete mundesine per zbulimin e fushes se forte magnetike ne afersi te tij. Ne rastin e tentimit te heqjes se nje nga mbulesave te matesit ne nje hapësire 1 mm gjate perdorimit ose ne qofte se ne afersi te matesit ka fushe magnetike te forte, kjo ngjarje duhet te regjistrohet ne memorie dhe njekohesisht matesi duhet automatikisht te stakohet(matesi duhet te kete opsionin Tamper Switch) .

#### **Masteri i te dhenave**

Matesi duhet te kete te dhena te cilat jane ruajtur ne nje regjister specifik dhe i cili nuk mund te ndryshohet.

#### **Periudha e ruajtjes se te dhenave te faturimit**

Matesi duhet te kete mundesine per ruajtjen e te dhenave te faturimit ne nje periudhe jo me te shkurter se 13 perioda faturimi(energjia dhe fuqia mesatare maksimale). Periudha e mosfaturimit eshte 1 muaj. Pas skadimit te 13 periodave te faturimit , kur cikli i ri fillon, memoria e matesit duhet te siguroje

hapësire për bllokun e ri të memories, duke fshirë leximin me të vjetër në radhën e regjistrit. Përmbajtja e kësaj liste duhet të jetë e programueshme.

**Fuqia aktive mesatare 15 minuteshe (profile i ngarkeses)**

Matesi regjistron paraqitjen e ngarkeses për fuqinë aktive. Cdo e dhënë është regjistruar me datën dhe kohën e matjes. Matesi duhet të masë dhe ruajë në brendi së paku 4 regjistra fuqi mesatare 15 min. Matesi duhet të ketë mundësi për ndryshimin e periudhës së integruar.

Matesi duhet të ketë mundësi për ruajtjen e fuqisë mesatare 15 min në një periudhë jo më të shkurtër se 1 vit. Përmbajtja e kësaj liste është e programueshme.

Profili i ngarkeses duhet të jetë gjithashtu në gjendje të regjistrojë nivelet minimum, maksimum dhe mesatar të tensionit si edhe frekuencën në një periudhë 15 min.

**Monitorimi i cilësisë së rrjetit**

Matesi duhet të ketë mundësinë për të përcaktuar së paku katër pragje vlerash të tensionit për secilën fazë. Matesi duhet të ruajë së paku 1000 regjistrime. Përmbajtja e kësaj liste duhet të jetë e programueshme.

**4. Komunikimi me matesin**

Komunikimi i matesit duhet të sigurojë lidhjen midis matesit elektronik dhe paisjeve të ndryshme (konvertuesit, koncentratorit)

**Nderfaqet komunikuese**

Një mates duhet të përmbajë tre ndërfaqe komunikimi:

- Matesat janë të paisur me ndërfaqe komunikimi realizuar si porta IR (nderfaqe optike)
- Nderfaqja e dytë e komunikimit është ndërfaqja RS485. Kjo ndërfaqe është aktive dhe duhet të jetë e izoluar. Kjo ndërfaqe përdoret për lidhjen e portave të matesit.
- Nderfaqja e tretë është ndërfaqja RS232. Porta RS232 duhet të pranojë modulet GSM/GPRS bazuar në platformën e komunikimit përdorur deri tani përmes operatoreve të levizshëm. Modulet e komunikimit duhet të jenë të integruara në një mates, për shembull pashtet mbulesës së bllokut të terminalit të matesit. Një modem GPRS i cili është integruar në mates dhe përfshihet në mbulesën e terminalit duhet të funksionojë. Ata duhet të mundësojnë edhe lidhjen Ethernet.

**Protokollet e komunikimit**

Një mates duhet të mbajë protokollet e komunikimit DLMS/COSEM (IEC 62056-46). Matesit do të suportojnë këto protokoll në të gjitha ndërfaqet e komunikimit.

**5. MENAXHIMI I KONSUMIT**

**Celesi i kontrollit të ngarkesës Bi-stable**

Matesi ka të instaluar celesin korrespondues të kontrollit të ngarkesës bi-stable (dy gjendje) për komutimin on/of (kycur/c'kycur) në distancë të abonentit. Celesi i kontrollit bi-stable është montuar si bllok terminal i shtuar pashtet mbulesës së bllokut të terminalit të matesit.

Celesi i kontrollit të ngarkesës duhet të jetë për çkycjen e fazes ose totale në distancë dhe gjithashtu duhet të kontrollohet në largësi duke përdorur celsat lokal. Matesat duhet të kenë të integruar një rele trefazë që mund të përdoret për të shpërndarë furnizimin e një konsumatori në distancë ose të përdoret për parapagesë.

**Daljet e releve**

Matesit duhet te kene se paku nje rele kontrolli me karakteristikat 2A / 5V,

## 6. STANDARTET

### Standartet e aplikueshme

Matesat bidireksional te perdorur jane conform dhe plotesojn standartet e meposhtme:

- IEC 62052-11 Pajisjet per matjen e Energjise elektrike (AC) – Kerkesa te pergjithshem, Testime dhe kushtet e testimeve pjesa 11: Pajisjet matese (ekuivalent me EN 6205-11)
- IEC 62053-21 Pajisjet per matjen e Energjise elektrike (AC) – Kerkesa specifike, pjesa 21: Matesa Statik per energji aktive (klasi 1 dhe 2), (ekuivalent to EN 62053-21)
- IEC 62053-22 Pajisjet per matjen e Energjise elektrike (AC) - Kerkesa specifike, pjesa 22: Matesa Statik per energji aktive (klasi 0,2 S dhe 0,5 S)
- IEC 62053-23 Pajisjet per matjen e Energjise elektrike (AC) - Kerkesa specifike, pjesa 23: Matesa Statik per energji reaktive (klasi 2 dhe 3)
- IEC 62053-31 Pajisjet per matjen e Energjise elektrike (AC) - Kerkesa specifike, pjesa 31: Pajisje pulsuese dalese per matesa elektromekanik dhe elektronik (ekuivalent me EN 62053-31)
- IEC 62053-52 Pajisjet per matjen e Energjise elektrike (AC) - Kerkesa specifike, pjesa 52: Simbole
- IEC 62053-61 Pajisjet per matjen e Energjise elektrike (AC) - Kerkesa specifike, pjesa 61: Fuqia e konsumuar dhe kerkesat ne lidhje me tensionin
- IEC 62054-21 Pajisjet per matjen e Energjise elektrike (AC) – Kontrolli i ngarkeses se tarifuar, pjesa 21: Kerkesa te vecanta per komutatoret e kohes (ekuivalent me EN62054-21)
- IEC 62056-21 Matje elektrike – Shkembim te dhenash per lexim matesi, Tarifim dhe kontroll ngarkese – Shkembim lokal direkt i te dhenave (IEC61107)
- IEC 62056-42 Matje elektrike – Shkembim te dhenash per lexim matesi, Tarifim dhe kontroll ngarkese, pjesa 42: Sherbime fizike dhe procedura te orientuara drejt lidhjeve te shkembimit te te dhenave
- IEC 62056-46 Matje elektrike – Shkembim te dhenash per lexim matesi, Tarifim dhe kontroll ngarkese, pjesa 46: Nderlidhje e te dhenave duke perdorur protokollin HDLC
- IEC 62056-53 Matje elektrike – Shkembim te dhenash per lexim matesi, Tarifim dhe kontroll ngarkese, pjesa 53: Shtresa e aplikimit COSEM
- IEC 62056-61 Matje elektrike – Shkembim te dhenash per lexim matesi, Tarifim dhe kontroll ngarkese, pjesa 61: Sistemi i identifikimit te objektit (Object identification system - OBIS)
- IEC 62056-62 Matje elektrike – Shkembim te dhenash per lexim matesi, Tarifim dhe kontroll ngarkese, pjesa 62: Klasat e nderfaqjes
- EN55022/CISPR22 – Percakton (klasi B) emetimet radio-elektrike ne diapazonin > 150kHz
- Direktiva e perputhshmerise Elektromagnetike 2004/108/EC. Pajtueshmeria eshte demonstruar nga konformiteti me EN62052-11 dhe EN62053-21.

- Direktiva Europiane 2004/22/EC per matje dhe instrumentim (Measurement Instrument)

## 7. GARANCIA

Prodhuesi duhet te siguroje furnizimin e matesave dhe aksesoreve te tyre ne perputhje me tegjitha specifikimet dhe kerkesat e ketij standarti.

Matesit duhet te dergohen pa defekte, duhet te kene karakteristikat e kerkuara dhe te mos kene gabime te cilat reduktojne vlerat dhe karakteristikat e matesit..

Periudha minimale e garancise eshte vendosur 36 muaj nga data e dorezimit. Koha minimale per eliminimin e defekteve per zbatimin e periudhes se garancise eshte vendosur brenda 30 diteve pune, ose e brenda 14 dite pune per t'i ndruar.

## 8. DOKUMENTACIONI

- Percaktimi i sakte i tipit, prodhuesit dhe vendi I orgjines
- Pershkrimin teknik duke perfshire parametrat e kerkuar dhe aksesoret.
- Nje pershkrim I detajuar I nivelit te sigurise se matesit, mbrojtja kunder nderyhrjeve te paautorizuara.
- Pesha totale
- Jetegjatesia
- Instruksione per perdorim, montim dhe kerkesat per mirembajtje
- Një përshkrim i shkurtër i sistemit të menaxhimit të cilësisë së prodhimit, provat e mundshme dhe certifikatat përkatëse
- Kerkesa per transportim dhe levizje
- Raporetet e testeve me listen bashkangjitur te testeve
- Certifikata e testeve te pavarura
- Pershkrimi teknik, i nivelit te sigurise, mbrojtja kunder nderhyrjeve te paautorizuara, instruksionet per perdorim, mirembajtje, montim duhet detyrimisht te jene ne gjuhen shqipe.

### - MINIAUTOMATET TRE FAZORE TU

#### 1. Kerkesa te pergjitheshme

Ky specifikim paraqet kushtet e pergjitheshme teknike per blerjen dhe pranimin e miniautomateve TU tre fazore (Limitaret ), te cilet perdoren ne rrjetat e tensionit te ulet si celesa, si paisje mbrojtese.

Paisja duhet te jete konform standarteve IEC.

Pajisjet duhet të ndërtohen për të siguruar funksionimin e sigurte, mirembajtje, mbrojtjen ne punë dhe do të shënohet me një tregues të dukshem të sigurisë.

## Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



### 2. Kërkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje dokumentat e meposhtme.

- Certifikat e fabrikes ISO 9001
- Te dhena teknike sic kerkohen me poshte
- Karakteristikat e komutimit per automatet

### 3. Kushtet e sistemit

Te dhena per sistemin	Njesia	
Tensioni me I larte I sistemit	kV	0.66
Tensioni nominal	V	400
Frekuenca	Hz	50
Numri I fazeve	Nr	3 faze/4 percjelles
Sitemi I tokezimit		Direkt ne toke

#### Kushtet atmosferike

Temperatura maks. e ambientit	40°C
Temperatura min. e ambientit	-10 °C
Lageshtia relative maksimale	80%
Lartesia maks. mbi nivelin e detit	1000m
Ndotja	mesatare

### 4. Pershkrim, Kërkesa dhe te Dhena

Ky specifikim mbulon kërkesat per miniautomate te TU nje dhe tre fazore (Limitaret ) me qellim qe te perdoren ne rrejetat e tensionit te ulet si celesa dhe si element mbrojtës.

Miniautomatet e TU nje dhe tre fazore (Limitaret ) TU duhet te jene per perdorim te brendeshem.

Miniautomatet tre fazore

1	Numri I poleve		3
---	----------------	--	---

2	Ryma nominale ne 30°C, In	A	10,16(sipas kerkeses)
3	Rryma max qe nuk shkakton ckycje (Int)	A	1.13
4	Kapaciteti I ckycjes se lidhjes se shkurter	KA	6
5	Tensioni nominal	V	400
6	Tension I izolimit	V	500
7	Frekuenca	Hz	50
8	Numri i cikleve mekanike te punes		20000
9	Numri I cikleve elektrike te punes		8000
10	Kurba e komutimit		B,C (sipas skemes)

#### 5. Standartet e references

Miniautomatet e TU tre fazore (Limitoret ) TU duhet te plotesojne kerkesat e standartit IEC 898 dhe IEC 947-1-Z ( ose ekuivalentet e tyre)

#### 6. Ndertimi dhe materialet

Limitorët ( automatët ) e ofruar duhet të jenë të serisë standarte të prodhimit aktual dhe duhet të kenë siguri në përputhje me specifikimet e dhena.

Limitorët duhet të jenë të tipit që montohet në shinë dhe duhet të funksionojnë sipas kurbës së komutimit tip B.

Limitoret brenda boksit individual duhet te jene te vendosur ne menyre te tille , qe te lejoje manipulimin e tij nga konsumatori, dhe njekohesisht te parashikojte eliminimin e c’do mundesie vjedhjeje te energjise elektrike.

#### 7. Tests

Llojet e testeve do te kryhen ne perputhje me standartet IEC 898 dhe IEC 947-1-2

#### 8. Sherbime

Furnizuesi duhet te siguroje 3 paketa nga dokumentat e meposhtme:

- Karakteristikat e komutimit
- Vizatimet strukture,
- Manualin e perdorimit


#### Aneks 1

##### Skema Nr.1

Skema elektrike e panelit te tensionit te ulet me kater dalje



**SKEMA E PANELIT TU KABINES**



**SHENIME:**

Ne kete flete paraqitet skema elektrike njevijeshe e panelit TU me kater dalje, per ambient te brendshem, te kabinave TM/TU.

Paneli eshte i paisur me transformatore rryme kryesore 800/5 per gjithë ngarkesen e kabines si dhe transformatore rryme 250/5 per cdo dalje. Montimi i transformatoreve te rrymes per daljet eshte opsional ( kjo percaktohet sakte ne kerkeses).

Paneli eshte i paisur edhe me mates bilanci kryesor.

Per mbrojtjen e qarqeve te tesionit qe furnizojne matesat e vendosur ne panelin e matjes dhe ne vet panelin TU, eshte parashikuar nje miniautomat(limitator) trefazor 10A, 400V, klasa C.

Per mbrojtjen e qarqeve te ndricimit dhe prizave, eshte parashikuar nje miniautomat(limitator) trefazor 10A, 400V, klasa B

Per lidhjen e matesave do te perdoren kablllo Cu 4x2.5 mm<sup>2</sup> per qarqet e tesionit dh kabell Cu6x2.5 mm<sup>2</sup> per qarqet e rrymes.

Per prezencen e tesionit ne hyrje eshte parashikuar edhe llamba LED me indikacion per te tre fazet.

Temperatura brenda boksit ne pjesen e sipërme te tij te mos jete me shume se 60 °C

Paneli duhet te mbyllet me dryn.

Paneli duhet te kete hapësire rezerve per montimin ne prespektive edhe te nje automati tjetër, per nje dalje tjetër rezerve, si dhe per transformatorët e rrymes perkates.


Per ilustrim eshte mare skema e panelit per trasformator fuqie 400 kVA.

Te gjitha materialet perberese te panelit do te jene ne perputhje me specifikimet teknike te OSHEE.


Gjate zbatimit te punimeve te zbatohen te gjitha kushtet teknike te OSHEE.

**Skema per variantin me tre dalje**

Specifikime Teknike – Kabina parafabrikat




Skema per variantin me dy dalje




Kompozimi panelit duhet te behet ne menyre te tille qe te respektohen standartet e panelit ne teresi, standartet e punes se paisjeve, sigurimi teknik e tje. Kujdes duhet te tregohet me ventilimin ne menyre qe temperatura maksimale ne pjesen e sipërme te panelit te mos kaloje 60 °C.

Gjeresia e panelit prej 880-900 mm duhet te mbetet e pa ndryshueshme.

Varianti perfundimtar i prodhimit te panelit do te vendoset pas miratimit nga ana e bleresit.



Per trasformator 160 KVA dhe trasformator 250 KVA



Per trasformator 400 KVA dhe trasformator 630 KVA

Dimensionet me siper jane orientuese.

Gjeresia 880 mm eshte e pandryshueshme.

Paneli do te ndertohej sipas skemes me siper.

Temperatura ne pjesen e siperme te panelit nuk duhet te kaloje 60 °C

Ai duhet te permbaje edhe nje hapshire per vendosjen e paisjeve per mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike, mates smart 230/400V, 5A si dhe paisjet per komunikim me sistemin.

Varianti perfundimtar i prodhimit te panelit do te vendoset pas miratimit nga ana e bleresit.

## B- URAT(KABLLI) TU TRASFORMATOR – PANEL

### 1 Te pergjithshme

Materialet e meposhtme duhet te jene konform te gjitha specifikimeve teknike.

Materiali eshte projektuar per te punuar ne rrjet ne kushte atmosferike te ndryshme pa u demtuar.

Kablli duhet te punojne ne kushtet e ndryshimeve te ngarkeses dhe tensionit nga lidhja e shkurter apo ndonje tjetere demtim qe mund te ndodh dhe te siguroje vlerat nominale ne paisje.

Te gjitha materialet e perdorura per prodhimin e kabllit me nje dell duhet te jene cilesia me e mire dhe i pershtatshem per pune ne kushtet e specifikuara me poshte.

### 2 Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje:

- Te dhena teknike sic kerkohen ne specifikime teknike
- Te gjitha test raportet e fabrikes
- Skicat dhe dimensione
- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001 ose ISO 9002

### 3 Kushtet e sistemit

Te dhena per sistemin	Njesia	
Tensioni me i larte i sistemit	kV	0.66
Tensioni nominal	V	400/230
Frekuenca	Hz	50
Numri i fazeve	No	3 faze/4 percjellesa
Sistemi I tokezimit		Direct ne toke
<b>Kushtet atmosferike</b>		
Temperatura max.e ambientit		40°C
Temperatura min.e ambientit		-10 °C
Lageshtia max. relative		80%
Lartesia max nga niveli I detit		1000m

### 4 Pershkrim, Kerkesa dh te dhena

#### Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Kabli i cili do te perdoret ne sistemin e shperndarjes perbehet nga percjelles alumini.  
Percjellesi i aluminit eshte i perbere nga tela alumini me seksion rrethor ne formen e nje litari.  
Percjellesit e aluminit duhet te kene 99.5% shkallen e pastertise.  
Izolacioni do te jete XLPE.  
Mbulesa duhet te jete me PVC me ngjyre te zeze , rezistente dhe te mos e perhap zjarrin. Kabli duhet te perdoret ne tension  $U_n=0,6 / 1$  kV.

**Te dhena teknike kabell 1x---mm<sup>2</sup>**

Seksioni i percjellesit (mm <sup>2</sup> )	Diametri i Jashtem( peraf.) (mm)	Rryma lejuar ne ajer (A)	Maxi mum DC Resistance @20° C	Temp e lejuar e percjellesit per l.shkurter deri 5 sek (°C)	Temp maksimale e lejuar e punes (°C)
50	14.2	175	0.641	250	90
70	16.2	209	0.443	250	90
95	18.3	250	0.320	250	90
120	20.2	286	0.253	250	90
150	22.4	330	0.186	250	90
185	24.7	380	0.164	250	90
240	27.7	450	0.125	250	90
300	30.6	530	0.100	250	90

**5 Perdorimi**

Kabli perdoret ne rrjetin e shperndarjes se energjise elektrike deri ne 1000 V ne punime industriale dhe civile.

Eshte projektuar per tu perdorur ne ambient te jashtem dhe te brendshem dhe mund te instalohet ne mur , ne struktura metalike ne kanalina ose mund te instalohet direkt ne toke.

Temperatura minimale e lejuar per zgjatjen e kabllit eshte +40 C<sup>0</sup>. Rrezja e lejuar e perkuljes se percjellesit gjate shtrimit te tij eshte 15d, ku “d” eshte diametri mesatar i jashtem i kabllit.

**6 Standartet**

Kabllot duhet te projektohen konform standarteve me te fundit ose ekuivalenteve te tyre si psh

VDE 0276-626/4F

S SH HD 308 S2:2001 Identifikimi i berthamave ne kabllot dhe kordonet fleksibel

S SH HD 361 S3:1999 Sisteme per projektimin e kablllove

S SH HD 361 S3:1999/A1:2006

S SH HD 361 S3:1999/AC: 1999

S SH HD 516 S2:1997: Udhezues per perdorimin e kablllove te harmonizuar te tensionit te ulet

S SH HD 516 S2:1997/A1:2003  
S SH HD 516 S2:1997/A2:2008  
S SH HD 603 S1:1994: Kabllot e shpërndarjes me tension te vleresuar 0,6/1 kV  
S SH HD 603 S1:1994/A1:1997  
S SH HD 603 S1:1994/A2:2003  
S SH HD 603 S1:1994/A3:2007  
S SH HD 604 S1:1994: Kabllot e fuqise 0,6/1 kV dhe 1,9/3,3 kV me performance speciale ndaj zjarrit per perdorim ne stacionet ektrike  
S SH HD 604 S1:1994/A1:1997  
S SH HD 604 S1:1994/A2:2002  
S SH HD 604 S1:1994/A3:2005  
S SH HD 605 S2:2008:Kabllot elektrik - Metodot shtese te proves  
S SH HD 627 S1:1996/A1:2000  
S SH HD 627 S1:1996/A2:2005  
S SH EN 50363-0:2011 Materialet e izolimit, mbuluese dhe veshese per kabllot e energjise me tensioni te ulet – Pjesa 0: Paraqitje e pergjithshme  
S SH EN 50363-4-1:2005: Materalat e izolimit, veshjes dhe mbulimit per kabllot elektrik te tensionit te ulet - Pjesa 4-1: Materalat veshese prej PVC-je  
S SH EN 50363-4-1:2005: Materalat e izolimit, veshjes dhe mbulimit per kabllot elektrik te tensionit te ulet - Pjesa 4-1: Materalat mbuluese prej PVC-je  
S SH EN 50363-5:2005: Materalat e izolimit, veshjes dhe mbulimit per kabllot elektrik te tensionit te ulet - Pjesa 5: Materalat elektroizolues te rrjetezuar pa halogjene  
S SH EN 50363-5:2005/A1:2011  
S SH EN 50395:2005: Metodot elektrike te testimi per kabllot elektrk te tensionit te ulet  
S SH EN 50395:2005/A1:2011  
S SH EN 50395:2005: Metodot jo elektrike te testimi per kabllot elektrk te tensionit te ulet  
S SH EN 60228:2005: Konduktoret e kablllove te izoluar  
S SH EN 60719:1993: Llogaritja per kufijte e poshtem dhe te siperm per permasat e jashtme mesatare te kablllove me percjelles rrethore prej bakri dhe tensionet e vleresuar mbi dhe duke perfshire 450/750 V.  
S SH EN 60754:2014: Prova mbi gazet e ciluar gjate djegies se materialeve nga kabllot - Pjesa 1: Percaktimi i permbajtjes se gazit acid halogjen  
S SH EN 60811-100:2012: Kabllot elektrike dhe kabllot me fibra optike - Metodot e proves per materalat jo- metalike - Pjesa 100: Te pergjithshme  
S SH EN 60811-201:2012: Kabllot elektrike dhe kabllot me fibra optike - Metodot e proves per materalat jo- metalike - Pjesa 201 Provat e pergjithshme - Matja e trashesise se izolimit  
S SH EN 60811-203:2012: Kabllot elektrike dhe kabllot me fibra optike - Metodot e proves per materalat jo- metalike - Pjesa 203: Provat e pergjithshme - Matja e permasave teresore  
S SH EN 60811-301:2012: Kabllot elektrike dhe kabllot me fibra optike - Metodot e proves per materalat jo-metalike - Pjesa 301: Provat e pergjithshme -Matja e konstantes dielktrike te perberjeve mbushese ne 23 °C  
S SH EN 60811-402:2012: Kabllot elektrike dhe kabllot me fibra optike - Metodot e proves per materalat jo- metalike - Pjesa 402: Provat te ndryshme - Provat e perthithjes se ujit  
S SH EN 60811-405:2012: Kabllot elektrike dhe kabllot me fibra optike - Metodot e proves per materalat jo-metalike - Pjesa 405: Provat te ndryshme - Prova e stabilitetit termik per izolimet me PVC dhe veshjet prej PVC

## 7 Shenime

Ne kabllot nje dejesh te tensionit te ulet shenimet duhet te jene te stampuara.  
Ne kabell duhet te jene te shenuara shkrimet e meposhtme:

- Marka e prodhuesit

- Standartet referuese
- Shenimi qe identifikon numrin serial dhe vitin e prodhimit.
- Seksioni dhe materiali I percjellesit
- Tensioni i izolimit (1000 V)
- Lloji i materialit izolues

Shenimi do të ketë permasa të njafgueshme për t'u lexuar në raport me diametrin e kabllit. Hapësira ndërmjet dy shenimeve te njepasnjeshme nuk do t'i kalojë 50 cm.

## 8. Testimet

### Llojet e testimit

Llojet e testimit do te kryhen sic eshte specifikuar ne Standartet HD 603 S1part 5G 2 .

- Matja e rezistences elektrike
- Testi me tesion 4 kV , 50 Hz, 5 min.

## C. TAPET DIELEKTRIK

### Illustration

(Ilustrimet eshte orientues)



### Pershkrimi

Tapeti dielektrik perbehet prej materiali gome me cilesi te larte dhe sipërfaqe jo te reshqiteshme. Ai do te jete ne perputhje me kerkesat e standartit IEC 60243-1, IEC 61111. Per nje siguri ekstreme ai ka njesere shtresash izoluese MAT per nje game te gjere perdorimi. Materiali, struktura dhe te gjitha karakteristikat e tjera do te jene ne perputhje me standartin e me siperm si dhe te gjithe standrtet e tjera ekuivalente.

Tapetet dielektrike per tensionet e mesme fillojne me klasat 2, 3, 4

### Te dhena teknike

Clasa	Tensioni punes (V)	Permasat (mm)
1	7500	1000x1000x6
2	17000	1000x1000x6
3	26500	1000x1000x9


4	36000	1000x1000x12
---	-------	--------------

Shenim: Tapeti do te zgjidhet ne funksion te TM te paisjeve te kabines.



Trashësia e tapetit me siper eshte orientuese. Ajo duhet te jete ne perputhje me klasen e izolimit duke respektuar standartet perkatese.


#### IV- STACIONI I TRANSFORMIMIT PARAFABRIKAT


Ilustrimi  
(Orientues)













Prerje e bazamentit ne dimensionin 298 cm



Prerje e bazamentit ne dimensionin 4180 cm



## 1 Te përgjithshme

Kabinat parafabrikat 20/0.4 kV funksionojne manualisht.

## 2 Kërkesa

Kabinat parafabrikat duhet te jene ne perputhje me Standartet IEC, EN publikimet e fundit (ose ekuivalentet e tyre):

- IEC 62271- 202:2014 Pajisje komutimi dhe kontrolli për tension të lartë-Pjesa 202:Nënstacione të parafabriuara tension i lartë/tension i ulët(High-voltage switchgear and controlgear - Part 202: High-voltage/ low-voltage prefabricated substation).
- EN 62271-202 Pajisje komutimi dhe kontrolli për tension të lartë-Pjesa 202:Nënstacione të parafabriuara tension i lartë/tension i ulët(High-voltage switchgear and controlgear - Part 202: Highvoltage/ low-voltage prefabricated substation ;Incorporating corrigendum September 2014).
- IEC 62271-200 Pajisje komutimi dhe kontrolli të tensionit të lartë -Pajisje komutimi dhe kontrolli AC Te asambluara ne kuti metalike për tension të vlerësuar mbi 1 kV deri dhe 52 kV përfshirë(High-voltage switchgear and controlgear - Part 200: AC metal-enclosed switchgear and controlgear for rated voltages above 1 kV and up to and including 52 kV)
- IEC 60076 Transformatoret e fuqise(Power transformers)
- IEC 60947-1 Pajisjet shpërndarëse dhe te kontrollit të tensionit të ulët-Regullat e përgjithshme(Low-voltage switchgear and controlgear - Part 1: General rules)
- DIN EN 12843 Produkte të parafabriuara të betonit - Shtyllat dhe traret (Precast concrete products - Masts and poles)
- DIN EN 10080 Çelik për përforcimin e betonit - Çelik i përforcuar i saldueshëm - Të përgjithshme (Steel for the reinforcement of concrete - Weldable reinforcing steel – General)
- DIN EN 12620 Agregatet e betonit(Concrete aggregate)
- DIN EN 1097- 1 Provat për vetitë fizike dhe mekanike të agregateve - Pjesa 1: Përcaktimi i rezistencës ndaj fërkimit (mikro-Deval)(Tests for mechanical and physical properties of aggregates - Part 1: Determination of the resistance to wear (micro-Deval)
- DIN EN 1097-2 Provat për vetitë mekanike dhe fizike të agregateve - Pjesa 2: Metoda të përcaktimit të rezistencës ndaj copëzimit Tests for mechanical and physical properties of aggregates - Part 2: Methods for the determination of resistance to fragmentation
- DIN EN 1367- 1 Prova për vetitë termike dhe klimaterike të agregateve - Pjesa 1: Përcaktimi i rezistencës në ngrirje dhe shkrirje (Tests for thermal and weathering properties of aggregates - Part 1: Determination of resistance to freezing and thawing )
- DIN EN 196- 1 Metoda prove për çimento - Pjesa 1: Përcaktimi i fortësisë (Methods of testing cement - Part 1: Determination of strength)
- DIN EN 196- 7 Metoda prove për çimento - Pjesa 7: Metoda për marrjen dhe përgatitjen e mostrave të çimentos (Methods of testing cement - Part 7: Methods of taking and preparing samples of cement)

- DIN EN 197-1 Çimento - Pjesa 1: Përbërja, karakteristikat dhe kriteret e konformitetit për çimentot e zakonshme (Cement - Part 1: Composition, specifications and conformity criteria for common cements)
- DIN EN 197-2 Çimento - Pjesa 2: Vlerësimi i konformitetit (Cement - Part 2: Conformity evaluation)
- EN 1992-1-2 Eurokodi 2 — Projektimi i strukturave të betonit - Pjesa 1-2: Projektimi strukturor për zjarrin (Eurocode 2: Design of concrete structures - Part 1-2: General rules - Structural fire design)
- DIN EN 1994-1-1 Eurokodi 4: Projektimi i strukturave kompozite çelik dhe beton - Pjesa 1-1: Rregulla të përgjithshme dhe rregulla për ndërtesa Eurocode 4: Design of composite steel and concrete structures - Part 1-1: General rules and rules for buildings
- BS EN 61000-6-1 Pajtueshmëria elektromagnetike (EMC) — Pjesa 6 - 1: Standardi i përgjithshëm — Rezistenca për mjediset e banesave, tregtare dhe industrisë së lehtë (Electromagnetic compatibility (EMC) Generic standards. Immunity for residential, commercial and light-industrial environments)
- EN 61000-6-2 Elektromagnetike (EMC) - Part 6-2: Standardet generike. Imuniteti për mjediset industriale (Electromagnetic compatibility (EMC) - Part 6-2: Generic standards. Immunity for industrial environments)
- BS EN 61000-6-3 Pajtueshmëria elektromagnetike (EMC) - Pjesa 6-3: Standarde të përgjithshme - Standarde për emetimet në mjediset banimi, tregtare dhe të industrisë së lehtë (Electromagnetic compatibility (EMC) Generic standards. Emission standard for residential, commercial and light-industrial environments)
- BS EN 61000-6-4 Përputhshmëria elektromagnetike (EMC) - Pjesa 6 - 4: Standarde të përgjithshme - Standarde për emetimet në mjediset industriale (Electromagnetic compatibility (EMC) Generic standards. Emission standard for industrial environments)
- BS EN 60068 Provat e mjedisit (Environmental testing Tests)
- DIN EN 1928 Fletë bitumi, plastike dhe gome për hidroizolim të çatisë - Përcaktimi i papërshkueshmërisë së ujit (Bitumen, plastic and rubber sheets for roof waterproofing - Determination of watertightness)

#### **Baza ligjore**

- Ligji Nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”
- Vendimi i ERE nr.100, date 26.8.2008 “Kodi\_Shpërndarjes”
- Vendimi i ERE nr.101, date 2.8.2008 “Kodi Matjes”
- Vendimi i ERE nr.123, date 24.10.2008 “Kodi\_Trasmetimit”
- ERE “Per Lidhjet e Reja ne Sistemin e Shpërndarjes”
- “Rregullore e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik per Impiantet, Instalimet dhe Paisjet Elektrike”
- Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”
- VKM 68 15.2.2001 “Per Miratimin e Standardeve dhe Kushteve Teknike Te Projektimit dhe Zbatimit te Punimeve te Ndertimit”
- Ligji nr.8405, date 17.9.1998 per “Urbanistikën”
- Ligji nr.8402, date 10.9.1998 per “Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”
- Ligji Nr. 10 440, dt 7.7.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”

- Ligji Nr.9537 date 18.05.2006 “Per Administrimin e Mbetjeve te Rrezikeshme ( i permiresuar me LigjinNr.9890 date 20.03.2008)”
- Ligji nr. 8934, date 5.9.2002 per “Mbrojtjen e mjedisit”
- Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 “ Për zonat e mbrojtura ”
- VKM Nr.249, dt 24.04.2003 “Për Miratimin e Dokumentacionit për Leje Mjedisore dhe të Elementeve të Lejes Mjedisore”
- VKM nr 587 date 07.07.2010 “Per monitorimin dhe kontrollin e nivelit te zhurmave ne qendrat urbane e turistike”
- Ligji Nr.152 dt. 21/12/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”
- Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 425, datë 24.7.2015: Për pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dhe lëshimin e akteve teknike.
- Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 424, datë 24.7.2015: ”Për miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në ndërtimet e destinuara për banim”

Kushtet e sistemit:

Specifikimet	Njesia	Sistemi 20 kV	Sistemi 0.4 kV
Te dhena per sistemin			
Tensioni me I larte I sistemit	kV	24	0.66
Tensioni nominal	kV	20	0.4 / 0.23
Frekuenca	Hz	50	50
Numri I fazeve	Nr	3	3 faze/4 percjelles
Sistemi I tokezimit	-	I izoluar	Direkt ne toke
Rryma ne lidhje te shkurter	kA	20	20

Kushtet atmosferike:

Temperatura maksimale e ambientit	+ 40 °C
Temperature minimale e ambientit	- 10 °C
Temperatura mesatare maksimale ditore	+ 30 °C
Lageshtia relative maksimale	80 %
Lartesia maksimale mbi nivelin e detit	1000 m

Testet fizike dhe elektrike te pranimit do te behen ne perputhje me standartet IEC.

### 3 Kabina e parafabrikuar (pjesa ndertimore)

Ky specifikim mbulon kerkesat per kabinat parafabrikat me dysHEME betoni per transformator deri 630 KVA.

Kjo kabine vendoset ne vende me akses per publikun, si rrjedhim kushtet e shfrytezimit dhe operimit te saj duhet te jene te sigurta per publikun.

Dimensionet e peraferta te kabines jane dhene ne skemat me siper. Ne to eshte mare parasysh gjeresia e celave TM max 600 mm. Ne te gjitha rastet kabinat duhet te plotesojne kerkesat per funksionimin normal te paisjeve te zgjedhura, punen normale dhe sigurine e personelit per montim dhe shfrytezim.

Ne projekte jepen detaje dhe permasat.

Para furnizimit, ofertuesi duhet te miratoje te investitori projektin perfundimtar te kabines.

Duhet te sigurohet nje siperfaqe e majftueshme pune per transformatorin e fuqise dhe paisjet e tjera si dhe nje ventilim i mjaftueshem i llogaritur per transformator 630 KVA duke siguruar korente ajri nepermjet zhaluzive. Dhoma e transformatorit do te kete dere me vehte.

Kabina duhet te jete e ndertuar me nje teknologji te tille qe ti duroje kushteve klimatike vecanerisht lageshtise dhe temperaturave te larta. Armaturat metalike te kabines duhet te jene te mbrojtura nga induktimet dhe fusha elektrostatische te tjera.

Ndertimi duhet te jete i tille qe qe te merret ne konsiderate edhe transporti i kabines se bashku me paisjet pa transformatorin e fuqise. Per kete duhet te sigurohet nje pllakate ne pjesen e brendeshme te kabines qe tregon pozicionin e ngritjes se saj me vinxh. Paneli TU duhet te fiksohet ne mur ose dysHEME.

Kabina duhet te kete shkalle mbrojtje IP 33D.

Ne ndertimin e kabines duhet te konsiderohet:

Veprimi I eres	Shpejtesia e eres $V=35\text{m/s}$
Veprimi sizmik	e vleresuar = 8 Merkali grade
Ngarkesa gjate transportit e kabines se kompletuar, pa transformatorin e fuqise	
Ngarkesa statike dhe dinamike mbi dyshemene e kabines ne kushte normale	

Kabina duhet te garantoje mbrojtjen e operatoreve si dhe te publikut te gjere sipas klases IAC-AB 20kA per 1 sek.

Kabina parafabrikat perbehet nga tre pjese kryesore

- trupi
- catia
- bazamenti + zona e kablllove

#### 3.1 Trupi

Kabina duhet te realizohet me structure monolite(me derdhje sipas metodes zanore) perbere nga beton perforcuar (beton I armuar) me cilesi shume te larte per te siguruar nje siperfaqe te sheshte dhe homogjene. Ajo duhet te jete me vetembajtje.

Kabina realizohet si nje pjese e vetme prej hekur betoni te perforcuar me cilesi shume te larte. Betonit qe do te perdoret per realizimin e konstruktit te kabines BOX, duhet t'i shtohet nje lende e pershtatshme fluidifikante e pa depertueshme ne menyre qe te merret nje hidroizolim adekuat dhe te mbrojtur kundër depërtimit të ujit neper capillaret.

Muret dhe bazamenti duhet te jene me beton C 35 ndersa dysHEMEJA C45( e sakta percaktohet nga llogaritjet).

Ne mur duhet te jene inkorporuar te gjitha paisjet(pershire dado bullona) te nevojshme per montimin e panelit TU dhe sistemit te tokezimit

Muret e jashteme suvatohen me llac plastik me madhesi te kokres 2 mm.

Muret dhe dyshemeja duhet te sigurohet me te gjithe aksesoret dhe mjetet per montimin e paisjeve, dritareve per ajrim si dhe hapsirat per hyrje dalje kablllove dhe sistemit te tokezimit.

### 3.2 Catia(soleta)

Catia ka te njejtin ndertim me trupin, me structure monolite me hekur betoni me cilesi shume te larte (marka sipas llogaritjeve) me hekur me qendrushmeri te larte me derdhje sipas metodës zanore dhe vendoset mbi muret e trupit

-catia vendoset dhe sigurohet ne udhezuesit ne qoshet e trupit te kabines me anen e anesoreve fleksibel, te cilat eliminojne ngrohjen e mureve anesore

-pergjate perimetrit te trupit te kabines ne hapësiren midis catise dhe mureve lihen vrima per ftohjen e saj

-ujrat largohen nga catia me anen e nje ulluku me tub PVC d=70mm

-ngjyra do te jete sipas nuancave RAL

Soleta duhet llogaritur qe te duroje nje peshe te shperndare ne menyre uniforme 400daN/m<sup>2</sup> dhe duhet te siguroje nje koeficient mesatar te trasmetimit te nxehtesise 3.1 W/°C m<sup>2</sup>. Soleta duhet te jete e fiksuar per te qene e sigurt dhe te kete termo izolim . Gjithashtu duhet te kete nje shtrese mbrojtese hidroizolimi nga shirat.

### 3.3 Bazamenti + Zona e kablllove

Për vendosjen ne toke te kabines Box si dhe per hyrjen e kablllove në kabine, duhet te ndertohet nje bazament parafabrikat per tu futur ne toke, kjo percaktohet sipas permasave te kabines Box. Prodhuesi duhet te parashikojë qe gjate montimit te kabines ne bazament, ne kabine te mos futen ujrata siperfaqesore.

Midis kabines BOX dhe bazamentit nuk është parashikuar asnje lidhje mekanike megjithatë, prodhuesi duhet të sigurojë bashkim te forte të tille qe të parandaloje çdo zhvendosje horizontale te vet Box- it dhe një system lidhje Box-Bazament te tille qe siguron izolim te plote te ujerave.

Bazamenti eshte i mbrojtur nga uji dhe ne te njejtën kohe sherben si rezervuar i grumbullimit te vajit gjate demtimit te transformatorit ne rastin e avarive, ai eshte i veshur me nje mbulesë rezistente ndaj vajit mineral

Bazamenti ndertohet me hekur betoni me cilesi shume te larte(marka C35) me hekur me qendrushmeri te larte me derdhje sipas metodës zanore (ultra tinguj), me bashkime me saldim te papershkueshme nga uji dhe gazrat.

Ai llogaritet qe te mbaje peshen e te gjithe kabines perfshire edhe paisjet dhe personelin .

Bazamenti dhe zona e kablllove ka edhe nje funksion me te gjere per te gjithe kabinen duke plotesuar funksionet e meposhteme:

- grumbullues i vajit gjate demtimit te transformatorit
- hapësira per shtrirjen e kablllove midis paisjeve te kabines
- hyrja dhe dalja e linjave kablllove te kabines te vendosura ne mbajtese kablllosh

Per hyrjen e kablllove jane parashikuar bira te posacme per kabllot TM dhe TU. Birat jane parashikuar ne te dy anet gjatesore. Per me teper shiko te pika 3.9 “Hyrja e kablllove”.



### 3.4 Dyert

Dyert duhet të jenë të një madhësie të tillë që të lejojnë montimin dhe demontimin e paisjeve teknologjike (Tr. 630KVA, celave TM, panelit TU). Ato lidhen elektrikisht me rrjetin e tokëzimit. Drejtimi i hapjes së dyerve duhet të jetë nga jashtë me një kënd hapje të pakten  $110^{\circ}$ . Përveç braves me tre rrugë bllokimi, ato përsen edhe me dryn dhe dritare ajrimi. Dyert ndërtohen prej materiali aliazh alumini me cilësi shumë të larta të cilat janë rezistent ndaj kushteve atmosferike, karkasat e tyre ndërtohen gjithashtu prej materiali aliazh alumini me trashësi 3mm. Dyert duhet të plotësojnë midis të tjerave edhe kushtet e mëposhtme:

- janë të testuara për rezistencë ndaj harkut
- standarti i furnizimit është me çelës me tre rrugë bllokimi (lart dhe poshtë vertikalisht si dhe horizontalisht)
- dyert mund të mbyllën nga brenda thjesht duke levizur një levë (i ashtuquajtur i sistemit paniku)
- për ventilim dera mund të pajiset me elemente ventilimi të çdo madhësie
- elementet e ventilimit ndërtohen prej materiali aliazh alumini rezistent ndaj kushteve atmosferike
- rezistenca ndaj futjes së insekteve dhe stinës së verës sigurohet me anën e rrjetit çeliku vendosur nga ana e brendshme.
- projektimi i dyerve dhe elementeve të ventilimit është një zgjidhje standarte e prodhimit dhe e të gjithë testeve që kryhen (rezistenca ndaj harkut, për përcaktimin e klasës së mbrojtjes së kabines, etj) dhe ato realizohen me anën e këtij projekti.
- kanatet e dyerve lidhen elektrikisht me kasën me përcjelles bakri të izoluar, fleksibel, Cu jo më të vogël se  $25 \text{ mm}^2$ .

Dyert duhet të kenë shkallë mbrojtje IP 33D.


Dyert do të jenë në përputhje me Standardet ndërkombëtare EN 60529, EN 50102, IEC 60112, dhe përmirësimet e tyre ose ekuivalentet e tyre. Ato do të paraqesin siguri dhe qëndrueshmëri edhe në kushtet klimatike që mbizotërojnë në vend.

### 3.5 Ajrimi

#### Zhaluzi

#### Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet janë orientuese)



Zhaluzite do të jenë në përputhje me Standardet ndërkombëtare EN 60529, EN 50102, IEC 60112, dhe përmirësimet e tyre ose ekuivalentet e tyre. Ato do të paraqesin siguri dhe qëndrueshmëri edhe në kushtet klimatike që mbizotërojnë në vend.

Ato janë të testuara për rezistencë ndaj harkut.

Ajrimi i kabines (përveç derës) bëhet nga dritare (zhaluzite) me grila metalike. Ventilimi llogaritet për transformator 630 KVA.

Ajrimi duhet te jete I tille qe te nxjerre nxehtesine ne ngarkese dhe temperature maksimale te ambientit. Zhaluzite duhet te kene shkalle mbrojtje IP 33D. Ato lidhen elektrikisht me rrejetin e tokezimit.

Detaje te sakta jepen ne fleten e projektit qe ben projektuesi.

Zhaluzite duhet te garantojne mbrojtjen e operatoreve si dhe te publikut te gjere sipas klases IAC-AB 20kA per 1 sek

### 3.6 Dyshemeja

Ajo pregatitet me structure monolite me hekur betoni me cilesi shume te larte (marka e betonit C 45 ose me lart) me hekur me qendrueshmeri te larte (te dyja percaktuar nga llogaritjet).

Dyshemeja duhet te mbaje nje ngarkese statike dhe nje ngarkese dinamike (ngarkesa max e levizshme, qe mund te vendoset kudo) qe t'i pergjigjet peshes se transformatorit dhe paisjeve per te cilat eshte projektuar si dhe personelit per punime e mirembajtje.

Ne te gjitha rastet ngarkesa statike nuk duhet te jete me e vogel se 500 kg/m<sup>2</sup> dhe ajo dinamike (ngarkesa max e levizshme, qe mund te vendoset kudo) deri 3000 kG.

Vendet e vendosjes se transformatorit jane paisur me mbeshtetese anti vibruese per zvogelimin e perhapjes se zhurmave.

### 3.7 Shenjat e sigurimit teknik dhe pengesat

Ne dyert e kabines se transformacionit (perfshire dhe ambjentin e transformatorit me vrimat e ventilimit) vendosen tre tabela te sigurimit teknik me shenimet e meposhteme:

1. Tabela tip TST1 me shenjen e rrufese me shenimin “Tension i larte – Rrezik vdekje!“, “Mos prek, rrezik vdekje”.
2. Tabela tip TST2 me fushe te ujit qe derdhet ne zjarr me shenimin “Te mos shuhet me uje ose me paisje me shkume!”
3. Tabela tip TST3 me shenimin “Ndalohet hyrja”.

Mbas hapjes se dyerve te ambjenteve te transformatoreve, per ndalimin e hyrjes vendosen dy pengesa te kuqe.

Ne vende te pershtateshme te paneleve TM/TU jane vendosur shenja te tjera te sigurimit teknik qe furnizohen nga operatori.

### 3.8 Pllakata

Ne pjesen e brendshme te kabines, prane deres duhet te je te e inkorporuar, ose e fiksuar nje pllakate qe tregon:

- Tipi
- Emri i prodhuesit
- Vitti i prodhimit,
- Peshja pa perfshire paisjet dhe me paisje (pa transformator)
- Menyra e ngritjes gjate transportit (nuk pershihet transformatori i fuqise)
- Numrin e standartit
- Numri serial
- Mbishkrimi qe rezistenca ndaj harkut te brendshem eshte IAC – AB

### 3.9 Hyrja e kablllove

Per hyrjen e kablllove TM, bazamenti eshte e paisur me 2 cope bushing standart ne cdo ane, te cilat jane shtrenguese ne forme bajonete me vrime te vecuar me  $d=150\text{mm}$ , te destinuar per perfshirjen e tyre ne korpus dhe qe jane te gateshme per montimin e kablllove. Furnizimi do te jete 2 cope bushing me tre vrime te vecuara ne cdo ane, perfshire dhe menget mbyllese hermetike. Ne gjendjen para montimit te kablllove bushings dhe vrimat jane te mbyllura hermetikisht dhe nuk lejojne depertimin e ujit dhe lageshtise brenda bazamentit. Vrimat e vecuara duhet te pershtaten per kablllo me diameter te jashtem minimumi 15 mm dhe maksimumi 55 mm. Birat qe do perdoren per kalimin e kablllove, pas futjes se ketyre te fundit ne bazament, duhet qe perseri te realizojne mbyllje hermetike duke mos lejuar depertimin e ujit dhe lageshtise brenda bazamentit.

Per hyrjen e kablllove TU, bazamenti eshte e paisur me 1x8 shtrenguese standart ne cdo ane, per perfshirjen e tyre ne korpus dhe qe jane te gateshme per montimin e kablllove. Ne gjendjen para montimit te kablllove vrimat jane te mbyllura hermetikisht dhe nuk lejojne depertimin e ujit dhe lageshtise brenda bazamentit. 5 nga vrimat e vecuara duhet te pershtaten per kablllo me diameter te jashtem minimumi 15 mm dhe maksimumi 55 mm, ndersa 3 vrime duhet te pershtaten per kablllo me diameter te jashtem minimumi 3 mm dhe maksimumi 17 mm . Birat qe do perdoren per kalimin e kablllove, pas futjes se ketyre te fundit ne bazament, duhet qe perseri te realizojne mbyllje hermetike duke mos lejuar depertimin e ujit dhe lageshtise brenda bazamentit.

Mund te pranohet edhe zgjidhje tjeter per hyrje-daljen e kablllove me kusht qe te respektohet numri i permendur me lart dhe hermeticiteti qe te garantoje mos futjen e ujit dhe lageshtise brenda bazamentit.

## 4 Instalimi I kabines ne rrjet

### *Instalimi i kabines ne rrjet*

Vendi ku do montohet kabina duhet te miratohet edhe nga MKZ(mbrojtja kunder zjarit).

Per instalimin e kabines ne rrjet duhet te germohet nje grope drejtkendore.

Per te gjitha rastet duhet te kihet parasysh dimensionet e sakta te kabines te cilat jepen nga prodhuesi. Ne vizatimet e mesiperme, dimensionet jane orientuese. Ne projekt jepen detaje te plota te punimeve civile lidhur me vendosjen e bazamentit sipas kushteve te terenit, llojit te tokes, ujrave nentokesore dhe siperfaqesore e tje.

Pas perfundimit te germimit te gropes, toka duhet te ngjshet me nje paisje ngjeshese.

Kjo grope duhet te mbushet me nje shtrese 100 mm te trashe (zhavor 6-8 mm).

Kjo shtrese duhet te ngjshet mire .

Ne zonat me rreshje te bollshme ose toka ujembajtese, rekomandohet te realizohet nje sistem drenazhimi perreth gropes.

Ne te gjitha rastet, ne funksion te qendrueshmerise se tokes, duhet te jape miratimin perfundimtar inxhinieri i specialitetit perkates.

### *Kerkesa te instalimit*

Instalimi i kabines realizohet me nje vinc me kapacitet 30 ton dhe lartesia maksimale e ngritjes 8 m.

1. Kerkesa per magazinim, dorzim dhe transport

Limiti I temperatures gjate transportit duhet te jete  $-40^{\circ}\text{C}$  deri  $+40^{\circ}\text{C}$  ne lageshti relative maksimale 80% ne  $+35^{\circ}\text{C}$ .

Te gjithë strukturat metalike, paisjet fiksuese, duhet te jene material anti korroziv ose celik i galvanizuar.

Dera duhet te jete e mbyllur me nje mekanizem kyces. Kyci duhet te jete bronzi i kromuar.

Te gjitha instalimet e jashtme duhet te fiksohen ne menyre te tille qe te cmontohen vetem nga brenda.

Te gjitha instalimet e jashtme(perfshire dhe dyert) duhet te jene te siguruara mire per te rezistuar nga vjedhjet e mundshme.

## 5 Punimet e brendshme

Kabina duhet te jete e perfunduar nga brenda dhe jashte.

Te gjitha nyjet dhe bashkueset duhet te jene rezistent ndaj ujit.

Pjesa e brendshme e mureve dhe tavani duhet te jene te lyera me ngjyre te bardhe.

Pjesa e jashtme duhet te trajtohet me shtrese plastike rezistente ndaj ujit bere me kuarc pluhur, oksid per te qene I qendrushem ne kushte atmosferike te ambientit.

Ngjyra e mureve duhet te jete bezh dhe soleta ngjyre gri.

## 6 Instalimet elektrike per ndricim

Instalimet elektrike realizohen ne tuba plastic inkorporuar ne konstruksionin e nderteses. Ato perfshijne:

Percjellsat e izoluar  $4 \times 2.5 \text{ mm}^2$ ,

Dy priza 240V/16A te inkastruara

Celesa te inkastruar si dhe ndricusa dhe nje miniautomat

Te gjitha paisjet dhe aksesoret duhet te jene te izoluar dhe duhet te garantojne mbrojtje nga prekja e rastesishme dhe mbrojtje nga zjarri.

Shkalla e mbrojtjes nuk do te jete me pak se IP 54.

## 7 Sistemi i tokezimit

S SH HD 627 S1:1996/A2:2005  
S SH EN 50363-0:2011 Materialet e izolimit, mbuluese dhe veshese per kabllot e energjise me tensioni te ulet – Pjesa 0: Paraqitje e pergjithshme  
S SH EN 50363-4-1:2005: Materalat e izolimit, veshjes dhe mbulimit per kabllot elektrik te tensionit te ulet - Pjesa 4-1: Materalat veshese prej PVC-je  
S SH EN 50363-4-1:2005: Materalat e izolimit, veshjes dhe mbulimit per kabllot elektrik te tensionit te ulet - Pjesa 4-1: Materalat mbuluese prej PVC-je
- S SH EN 50363-5:2005: Materalat e izolimit, veshjes dhe mbulimit per kabllot elektrik te tensionit te ulet - Pjesa 5: Materalat elektroizolues te rrjetezuar pa halogjene  
S SH EN 50363-5:2005/A1:2011  
S SH EN 50395:2005: Metodot elektrike te testimit per kabllot elektrk te tensionit te ulet  
S SH EN 50395:2005/A1:2011  
S SH EN 50395:2005: Metodot jo elektrike te testimit per kabllot elektrk te tensionit te ulet  
S SH EN 60228:2005: Konduktoret e kabllove te izoluar  
S SH EN 60719:1993: Llogaritja per kufijte e poshtem dhe te siperm per permasat e jashtme mesatare te kabllove me percjelles rrethore prej bakri dhe tensionet e vleresuar mbi dhe duke perfshire 450/750 V.  
S SH EN 60754:2014: Prova mbi gazet e cliruar gjate djegies se materialeve nga kabllot - Pjesa 1: Percaktimi i permbajtjes se gazit acid halogjen  
S SH EN 60811-100:2012: Kabllo elektrike dhe kabllo me fibra optike - Metodot e proves per materialet jo-metalike - Pjesa 100: Te pergjithshme  
S SH EN 60811-201:2012: Kabllo elektrike dhe kabllo me fibra optike - Metodot e proves per materialet jo-metalike - Pjesa 201 Provat e pergjithshme - Matja e trashesise se izolimit  
S SH EN 60811-203:2012: Kabllo elektrike dhe kabllo me fibra optike - Metodot e proves per materialet jo-metalike - Pjesa 203: Provat e pergjithshme - Matja e permasave teresore  
S SH EN 60811-301:2012: Kabllo elektrike dhe kabllo me fibra optike - Metodot e proves per materialet jo-metalike - Pjesa 301: Provat e pergjithshme -Matja e konstantes dielktrike te perberjeve mbushese ne 23 °C  
S SH EN 60811-402:2012: Kabllo elektrike dhe kabllo me fibra optike - Metodot e proves per materialet jo-metalike - Pjesa 402: Provat te ndryshme - Provat e perthithjes se ujit

S SH EN 60811-405:2012: Kabllo elektrike dhe kablllo me fibra optike - Metodat e proves per materialet jo-metalike - Pjesa 405: Provat te ndryshme - Prova e stabilitetit termik per izolimet me PVC dhe veshjet prej PVC

## 6. Projektimi dhe materiali

Kablli duhet te jete ne gjendje qe te punoje vazhdimisht ne temperature maksimale jo me shume se 90°C dhe duhet te prodhohen per ambient te jashtem dhe te brendeshem.

Percjellesit e aluminit duhte te kene 99.5% vleren e pastertise (elektrike).

## 7. Perdorimi

Kabllo e tensionit te ulet jane projektuar per tu instaluar nentoke por gjithashtu edhe ne ajer.

Temperatura ne lidhje te shkurter (max.5 sek.) eshte 250°C. Temperatura minimale e lejuar per shtrimin e kabllit eshte +4°C.

Rrezja e lejuar e perkuljes gjate shtrirjes se kabllit eshte 12d ( per kablllo me diameter 20 mm deri ne 40mm). Per kablllo me diameter mbi 40 mm rrezja e lejuar eshte 15d , ku “d” eshte diametri i jashtem i cdo kablli.

## 8. Shenime

Shenimet mbi mbulesen e kabllit te TU duhet te jene te shenuar ne menyre te paheqshme (tu qendrojne te gjitha agjenteve atmosferike). Per me teper ne kabllot e tensionit te ulet duhet te jene shenimet e meposhtme.

- emrin e prodhuesit
- standartet referuese
- Shenimi me emrin e prodhuesit dhe viti I prodhimit
- numri, seksioni terthor dhe diametri I percjellesve
- tensioni izolimit (1000 V)
- lloji I materialit izolues
- Shenimi I gjatesise, qe progresive duhet te filloje me vleren me te madhe me qellim qe gjatesia e kabllit te mbetur ne baraban te kete mundesi per tu lexuar.
- markim CE

Shenimi duhet te kete dimensione te dukshme ne lidhje me diametrin e kabllit per te qene lehtesisht te lexueshme. Hapesira ndermjet grupeve te njepasnjeshme nuk duhet ta tejkaloje 50cm.

## 9. Kerkesa per vendosjen e kabllit

Shtrirja e kabllit do kryhet ne perputhje me normat e standarteve IEC. Gjate shtrirjes se kabllit ,koka e kabllit duhet te mbulohet me kujdes me qellim mbrojtjen e tij nga demtimet dhe ndotja. Terheqja maksimale eshte  $P=S$ . ( ne te cilen S eshte seksioni I pergjithshem I kabllit ne  $\text{mm}^2$ ;  $\sigma$ , koeficienti I lejuar i sforcimit per shembull per percjellesit e aluminit eshte  $\sigma = 30\text{N} / \text{mm}^2$ . Gjate tendosjes se kabllit perdoret I njejti koeficient sforcimi per shtrirjen e tij.



## 10. Testimet

### Llojet e testimit

Llojet e testimit do te kryhen sic eshte specifikuar ne Standartet HD 603 S1part 5G 2 .

- Matja e rezistences elektrike
- Testi me tesion 4 kV , 50 Hz, 5 min.

## 11. Identifikimi dhe paketimi

Kabllo ambalazhohet ne barabane me nje gjatesi jo me pak se 500 m. Fundet e kabllave ne baraban duhet te izolohen kunder hyrjes se ujit dhe lageshtise. Barabanet e kabllave duhet te mbuloohen qe gjate magazinimit per nje kohe te gjate te jene te mbrojtur nga rrezatimi diellor.

Ne secilin baraban duht te jete shenuar:

- lloji i kabllit,
- seksioni,
- gjatesia e kabllit,
- emir i prodhuesit,
- viti i prodhimit,
- pesha bruto,
- numri I barabanit
- markimi CE

Barabanet bosh nuk rikthehen.

<b>III</b>	<b>Kablo fuqie TU (0.4kV Underground Power Cable)</b>			
<b>1</b>	<b>Te dhena te pergjitheshme (GENERAL DATA)</b>			
1.1	Tipi kabllit (Type of Cable)			
1.2	Prodhuesi (Manufacturer)			
1.3	Standarti aplikuar (Applied standard)			
<b>2</b>	<b>Te dhena (DATA)</b>			
2.1	Rezistenca max. AC/DC e percjellesit (Maximum AC/DC resistance of conductor)			
	@ 20°C	/km		
	@ 70°C	/km		
2.2	Rezistenca minimale e izolacionit (Minimum insulation resistance)			
	@ 20°C	/km		
	@70°C	/km		
2.3	Rryma per kohe te gjate (Continuous rated current)	A		
2.4	Temperature max e lejuar e percjellesit (Max. permissible conductor temperature)	°C		

Kabllo trefazore me kater percjellesa tensionit te ulet

2.5	Rryma e LSH e lejuar per 1 sek (Permissible 1 sec short circuit current)	kA		
2.6	Temperature korensponduese e percjellesit (Corresponding conductor temperature)	°C		
2.7	Qendrushermeria ndaj tensionit impulsive per kabllo (Withstand impulse voltage level for cable)	kV		
2.8	Tensioni nominal (Rated voltage) $U/U_0$	kV		
2.9	Gjatesia e kabllit e nevojshme per testet tip (Length of cable necessary for type testing)	m		
2.10	Diametri i jashtem i kabllit (Overall diameter of finished cable ) (State tolerance also)	mm		
2.11	Pesha e kabllit (Weight of finished cable)	kg/km		
2.12	Gjatesia max per nje baraban (Maximum length per drum)	m		
2.13	Rezja minimale e perkuljes se kabllit (Minimum bending radius of cable)	m		
<b>3</b>	<b>Percjellesi (CONDUCTORS)</b>			
3.1	Materiali percjellesit (Conductor material)			
3.2	Seksioni i percjellesit (Cross-sectional area of conductor)	mm <sup>2</sup>		
3.3	Kabllo me disa deje (Multi-core-cables):			
	- diametri percjellesit (Diameter of conductor)	mm		
	- nr. Percjellesave ne kabell (No. of conductors (cores) in cable)			
<b>4</b>	<b>Izolacioni (INSULATION)</b>			
4.1	Tipi izolacionit (Type of insulation)			
4.2	Trashesia e izolacionit (Thickness of insulation)	mm		
4.3	Pershkrimi mbuleses se perbashket vendosur mbi deje (Description of common covering over laid-up cores)			
4.4	Diametric mbi dejet (Diameter over laid-up cores)	mm		
4.5	Trashesia e mbuleses se perbashket te dejeve (Thickness of common covering of cores)	mm		
<b>6</b>	<b>Veshja (SHEATH)</b>			
6.1	Tipi veshjes se jashtme (Type of outer sheath)			
6.2	Trashesia e veshjes se jashtme (Thickness of outer sheath)	mm		
6.3	Bariera anti parazitare (Anti-vermin barrier)	Yes/No		
6.4	Fire retardation	Yes/No		

Me gene se termat jane teknike, baze do te jete emertimi ne anglisht.



1\_TDSH\_LV\_POWER  
\_CABLE.xlsx

# **SPECIFIKIME TEKNIKE**

## **KASETA METALIKE TU**

**KASETA METALIKE TU PER MONTIM NE SIPERFAQE TE MURIT OSE BRENDIA MURIT**

**Ilustrimi**

( Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



Kushtet e sistemit:

Specifikimet	Njesia	Sistemi ÷20 kV	Sistemi 0.4 kV
Te dhena per sistemin			
Tensioni me I larte I sistemit	kV	÷24	0.66
Tensioni nominal	kV	÷20	0.4 / 0.23
Frekuenca	Hz	50	50
Numri I fazeve	Nr	3	3 faze/4 percjelles
Sistemi I tokezimit	-	I izoluar	Direkt ne toke
Rryma ne lidhje te shkurter	kA	20	20

Kushtet atmosferike:

Temperatura maksimale e ambientit	+ 40 °C
Temperatura minimale e ambientit	- 10 °C
Temperatura mesatare maksimale ditore	+ 30 °C
Lageshtia relative maksimale	80 %
Lartesia maksimale mbi nivelin e detit	1000 m

### Pershkrimi dhe aplikimi

Kasetat metalike perdoren ne sistemin e furnizimit dhe te shperndarjes me energji elektrike per lidhjen dhe degezimin e kabllave.

Kaseta furnizohet me gjithë aksesoret e montimit.

Kasetat metalike jane te perbera prej flete celiku me trashesi 1.5 mm. Ana konstruktive duhet te jete e tille qe te siguroje qendrushmeri te larte ndaj goditjeve mekanike ne baze te standarteve perkatese. Te gjitha materialet jane te galvanizuara dhe te trajtuara me boje epoxy poliester RAL 7035 ose sipas kerkeses. Trashesia e bojës 60-80 micron.

Ato duhet te kene te stamposur ne pjesen e perparme shenjen e rezikut nga goditja elektrike. Prodhoen per ambient te jashtem per montim ne mur. Fiksimi ne sipërfaqe te murit behet ne kater pika me upa □ 10 me vide qe jane pjese e furnizimit. Ato mund te montohen edhe brenda murit. Dera hapet deri 170 ° majtas ose djathtas sipas kerkeses. Dera eshte e lidhur elektrikut me trupin e kasetes.

Ne mesin e kasetes, ne te gjithë gjatesine, duhet te jete montuar nje shine 35x15x1.5 prej llamarine celiku me rezistence te larte, per montimin e klemave me bulon. Zgjidhja konstruktive e montimit te saj duhet te jete e tille qe ajo te kete mundesi te levize vertikalisht lart e poshte ne te gjithë lartesine e kasetes si dhe neqofte se lind nevoja te shtohet nje shine e dyte.

Kaseta duhet te kete bulonin e tokezimit M10x25mm, te salduar ne qoshen e poshtme nga krahu i menteshave.

Kaseta ne pjesen e poshtme ka kater bira te paisura me cable glands te pershtateshme per kablllo 4x25 deri 3x150+70 mm<sup>2</sup>. Gjithashtu kaseta ka edhe nje bire te paisur me cable gland per percjellesin e izoluar te tokezimit me seksion deri 35 mm<sup>2</sup>. Ne dy faqet anesore, ne pjesen e sipërme, kaseta ka edhe nje kable glands ne cdo ane, te mbyllura qe hapen sipas nevojës per kabllot degezuese me seksion deri 4x95 mm<sup>2</sup>.

Ne gjendjen perfundimtare, gjate shfrytezimit, ajo duhet te kete nje shkalle mbrojtje IP66(perfshire ketu edhe cable glands).

Kaseta porositet me klema ose bosh sipas kerkeses. Ne rast se ne kerkesen nuk specifikohet asnje option, kaseta te shoqerohet me kater klema kompakte me dy bulona M10.

Kasetat metalike duhet te plotesojne kerkesat e standarteve perkatese si IEC 60439 - 3, BS EN 60439-3, IEC 60529, IEC 62262 e tje, si dhe te standarteve me te fundit ekuivalente.

Kaseta dhe materialet qe perfshihen ne te duhet te kene markim CE.


### Te dhena teknike

Materiali	Flete celiku 1.5 mm e galvanizuar e trajtuar me boje epoxy poliester
Tensioni nominal i rrjetit	230/400V, 50 Hz
Tensioni max. i paisjeve te montuara	1000V
Shkalla e mbrojtjes	IP66
Menyra e fiksimit	Me vida me upa ne kater pika ne mur ose direkt brenda murit
Hyrja dhe dalja e kablllove	Nga poshte
Hapja e deres	deri 170° majtas ose djathtas(sipas kerkeses)
Ambienti ku perdoret	Ne ambiente te jashtem
Sistemi bllokimit te deres	Me doreze te rotullushme si dhe me dryn
Permasat e jashtme	
LxHxD(mm)	500x400x250 ose 400x500x250 (sipas kerkeses) 400x300x200 ose 300x400x200 (sipas kerkeses) 600x400x250 ose 400x600x250 (sipas kerkeses)

### Shina per montimin e klemave

#### Ilustrim

(Ilustrimi eshte orientuese)



#### Peershkrimi:

Shinat per fiksimin e klemave kompakte me bulon jane prej llamarine celiku te galvanizuar me spesor 1.5mm. Ato jane te trajtuara edhe me boje epoxy poliester. Shinat jane te prodhimit standart dhe sherbejne per montimin e paisjeve modulare. Shinat kane qendrushmeri te larte mekanike(minimumi 15 kg ne distancen 100mm, sipas figures me siper).

#### Te dhena teknike

Tipi	DIN rail
Materiali	Llamarine celiku e galvanizuar spesor 1.5 mm e trajtuar me boje epoxy poliester
Gjeresia	35 mm

Lartësia e profilit	15 mm
Trashësia e metalit	1.5 mm

### Testet

Testet e kasetes jane sipas IEC 62208, EN 60 439

### Llojet e testeve

- Prova e deformimit,
- Fortësia e vidave dhe dadove,
- Shkalla e mbrojtjes,
- Qendrueshmëria mekanike shines


### Testet rutine

- Inspektime te pergjitheshme,
- Shkalla e mbrojtjes,
- Fortësia e vidave dhe dadove,
- Mbyllja e deres

## KASETA METALIKE TU PER MONTIM MBI BAZAMENT BETONI

### Ilustrimi

( Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



Kushtet e sistemit:

Specifikimet	Njesia	Sistemi ÷20 kV	Sistemi 0.4 kV
Te dhena per sistemin			
Tensioni me I larte I sistemit	kV	÷24	0.66
Tensioni nominal	kV	÷20	0.4 / 0.23
Frekuenca	Hz	50	50
Numri I fazeve	Nr	3	3 faze/4 percjelles
Sistemi I tokezimit	-	I izoluar	Direkt ne toke
Rryma ne lidhje te shkurter	kA	20	20

Kushtet atmosferike:

Temperatura maksimale e ambientit	+ 40 °C
Temperature minimale e ambientit	- 10 °C
Temperatura mesatare maksimale ditore	+ 30 °C
Lageshtia relative maksimale	80 %
Lartesia maksimale mbi nivelin e detit	1000 m

### Pershkrimi dhe aplikimi

Kasetat metalike perdoren ne sistemin e furnizimit dhe te shperndarjes me energji elektrike per lidhjen dhe degezimin e kabllave.

Kaseta furnizohet me gjithë aksesoret e montimit.

Kasetat metalike jane te perbera prej flete celiku me trashesi 1.5 mm. Ana konstruktive duhet te jete e tille qe te siguroje qendrushmeri te larte ndaj goditjeve mekanike ne baze te standarteve perkatese. Te gjitha materialet jane te galvanizuara dhe te trajtuara me boje epoxy poliester RAL 7035 ose sipas kerkeses. Trashesia e bojës 60-80 micron.

Ato duhet te kene te stamposur ne pjesen e perparme shenjen e rezikut nga goditja elektrike. Prodhoen per ambient te jashtem per montim ne bazament. Fiksimi ne bazament behet ne kater pika me bulona M8. Per kete arsye, ne kater qoshet e hekurave «L» te kornizes se poshtme, hapen kater bira(nje ne cdo qoshe) me diameter 10 mm, per futjen e bulonave. Bulonat jene fiksuar ne betonin e bazamentit. Kaseta nga poshte eshte e hapur me qellim qe te futen kabllot. Pjesa e sipërme e bazamentit te betonit nuk duhet te kete permasa me te vogela se permasat e jashtme te kasetes.

Lartesia nga toka e kasetes duhet te plotesoje kerkesat e rregullores se sigurimit dhe shfrytezimit teknik.

Dera hapet deri 170 ° majtas ose djathtas sipas kerkeses. Dera eshte e lidhur elektrikisht me trupin e kasetes.



Ne mesin e kasetes, ne te gjithë gjatesine, duhet te jete montuar nje shine 35x15x1.5 prej llamarine celiku me rezistence te larte, per montimin e klemave me bulon. Zgjidhja konstruktive e montimit te saj duhet te jete e tille qe ajo te kete mundesi te levize vertikalisht lart e poshte ne te gjithë lartesine e kasetes si dhe neqofte se lind nevoja te shtohet nje shine e dyte.

Kaseta duhet te kete bulonin e tokezimit M10x25mm, te salduar ne qoshen e poshtme nga krahu i menteshave.

Ne gjendjen perfundimtare, gjate shfrytezimit, ajo duhet te kete nje shkalle mbrojtje IP66(perfshire ketu edhe mbeshtetjen ne bazament).

Kaseta porositet me klema ose bosh sipas kerkeses. Ne rast se ne kerkese nuk specifikohet asnje option, kaseta te shoqerohet me kater klema kompakte me dy bulona M10.

Kasetat metalike duhet te plotesojne kerkesat e standarteve perkatese si IEC 60439 - 3, BS EN 60439-3, IEC 60529, IEC 62262, e tje, si dhe te standarteve me te fundit ekuivalente.

Kaseta dhe materialet qe perfshihen ne te duhet te kene markim CE.


### Te dhena teknike

Materiali	Flote celiku 1.5 mm e galvanizuar e trajtuar me boje epoxy poliester
Tensioni nominal i rrjetit	230/400V, 50 Hz
Tensioni max. i paisjeve te montuara	1000V
Shkalla e mbrojtjes	IP66
Menyra e fiksimit	Me bulona dhe dado M8 ne kater pika ne bazament.
Hyrja dhe dalja e kablllove	Nga poshte
Hapja e deres	deri 170° majtas ose djathtas(sipas kerkeses)
Ambienti ku perdoret	Ne ambient te jashtem
Sistemi bllokimit te deres	Me doreze te rotullushme si dhe me dryn
Permasat e jashtme	
LxHxD(mm)	500x400x250 ose 400x500x250 (sipas kerkeses) 400x300x200 ose 300x400x200 (sipas kerkeses) 600x400x250 ose 400x600x250 (sipas kerkeses)

### Shina per montimin e klemave

### Ilustrim

(Ilustrimi eshte orientuese)



### Peerskrimi:

Shinat per fiksimin e klemave kompakte me bulon jane prej llamarine celiku te galvanizuar me spesor 1.5mm. Ato jane te trajtuara edhe me boje epoxy poliester. Shinat jane te prodhimit standart dhe sherbejne per montimin e paisjeve modulare. Shinat kane qendrushmeri te larte mekanike(minimumi 15 kg ne distancen 100mm, sipas figures me siper).

### Te dhena teknike

Tipi	DIN rail
Materiali	Llamarine celiku e galvanizuar spesor 1.5 mm e trajtuar me boje epoxy poliester
Gjeresia	35 mm
Lartesia e profilit	15 mm
Trashesia e metalit	1.5 mm

### Testet

Testet e kasetes jane sipas EN 60 439

### Llojet e testeve

- Prova e deformimit,
- Fortesia e vidave dhe dadove,
- Shkalla e mbrojtjes,
- Qendrushmeria mekanike shines


### Testet rutine

- Inspektime te pergjitheshme,
- Shkalla e mbrojtjes,
- Fortesia e vidave dhe dadove,
- Mbyllja e deres

## KLEMA KOMPAKTE ME BULON PER QARQET E FUNIZIMIT DHE SHPERNDARJES

### Ilustrimi

( Ilustrimi eshte orientues)



### Pershkrimi dhe aplikimi

Klema kompakte me bulon sherbejne per fiksimin e percjellesave, per hapjen ose mbylljen e qarqeve elektrike. Ato jane te perbera prej pjeses percjellese, prej pjeses izoluse dhe prej pjeseve shtrenguse.

Pjeset izoluse jane te perbera prej plastike te riciklueshme. Jane te qendrushme ndaj rezatimit UV, kane qendrushmeri ndaj agjenteve kimike, kane elasticitet dhe qendrushmeri te larte mekanike, amortizim shume te ngadalte. Keto poliamide perdoren per temperatura operative te larta dhe kane ndezshmeri te klases V0 sipas UL94. Klemat ne pjesen e sipërme kane mbulesë plastike e cila mbulon pjeset percjellese. Edhe keto duhet te kene te njejtat karakteristika si pjesa tjeter izoluese.

Pjesa percjellese eshte prej aliazh bakri te nikeluar me percjellshmeri shume te mire. Kjo ben qe temperatura ne kontakt te jete e ulet.

Pjeset shtrenguese, sustat e tje, jane prej celiku te kromuar te afta te sigurojne nje force te larte shtrenguese. Ato duhet te durojne rymat ne perputhje me seksionin per te cilin jane projektuar. Bulonat shoqerohen me dy dado si dhe rondele pjate dhe suste.

Klemat duhet te kene qendrushmeri te larte mekanike (duhet te durojne nje force 15 kg ne distancen 100 mm sipas figures me siper).

Klemat duhet te plotesojne kerkesat e standartit IEC 60947-7, EN 60 947-7-1, EN 50124-1, DIN EN 61373, EN 50343 si dhe te standarteve me te fundit ekuivalente.

Klemat duhet te kene markim CE.

### Kleme kompakte me nje bulon per qarqet e funizimit dhe shperndarjes

#### Ilustrimi

( Ilustrimi eshte orientues)



Me nje bullon

#### Karakteristikat teknike

Buloni dhe dadua	M6	M8	M10
Seksioni percjellesit per te cilin perdoret (mm <sup>2</sup> )	÷ 35	÷70	÷ 120
Tensioni nominal i rrjetit (V)	230/400V,		
Tensioni max. qe duron (V)	1000V,		
Temperatura e punes	-30 °C deri 160 °C,		
Qendrushmeria ndaj tensionit impulsiv shkalle ndotje 3, (kV)	8 kV		
Menyra e fiksimit	shine DIN rail 35x15x1.5mm		

### Kleme kompakte me dy bulona per qarqet e funizimit dhe shperndarjes

#### Ilustrimi

( Ilustrimi eshte orientues)



Me dy bullona

#### Karakteristikat teknike

Bulonat dhe dadot	M6	M8	M10
Seksioni percjellesit per te cilin perdoret (mm <sup>2</sup> )	÷ 35	÷70	÷ 120
Tensioni nominal i rrjetit (V)	230/400V,		
Tensioni max. qe duron (V)	1000V,		
Temperatura e punes	-30 °C deri 160 °C,		
Qendrushmeria ndaj tensionit impulsiv shkalle ndotje 3, (kV)	8 kV		

Menyra e fiksimit

shine DIN rail 35x15x1.5mm

### Kleme kompakte me nje bulon dhe nje morsete per qarqet e funizimit dhe shperndarjes

#### Ilustrimi

( Ilustrimi eshte orientues)




#### Karakteristikat teknike

Bulonat dhe dadot	M6	M8	M10
Seksioni percjellesit per te cilin perdoret (mm <sup>2</sup> )	÷ 35	÷70	÷ 120
Morsete per percjelles me seksion (mm <sup>2</sup> )	÷ 50	÷90	÷ 150
Tensioni nominal i rrjetit (V)	230/400V,		
Tensioni max. qe duron (V)	1000V,		
Temperatura e punes	-30 °C deri 160 °C,		
Qendrushmeria ndaj tensionit impulsiv shkalle ndotje 3, (kV)	8 kV		
Menyra e fiksimit	shine DIN rail 35x15x1.5mm		

### Kleme kompakte shperndarese 1x(6 - 95)/6x(4 - 16) mm<sup>2</sup> per qarqet e funizimit dhe shperndarjes

#### Ilustrimi

( Ilustrimi eshte orientues)



#### Karakteristikat teknike

Seksioni percjellesit furnizimit(hyrja) per te cilin perdoret (mm <sup>2</sup> )	1x(6 ÷95)
Seksionet e percjellesave te shperndarjes(dalja) (mm <sup>2</sup> )	6x(4 ÷16)
Tensioni nominal i rrjetit (V)	230/400V,
Tensioni max. qe duron (V)	1000V,
Temperatura e punes	-30 °C deri 160 °C,
Qendrushmeria ndaj tensionit impulsiv shkalle ndotje 3, (kV)	8 kV
Menyra e fiksimit	shine DIN rail 35x15x1.5mm

# **SPECIFIKIME TEKNIKE**

## **KOKA(TERMINALE) KABLLI TM 20 KV**

## SPECIFIKIME KOKA(TERMINALE) KABLLI TM

### Te pergjithshme

Te gjitha terminalet e kabllit 20 kV jane projektuar qe te jene te sigurta ne kushte klimatike te ndryshme pa pesuar demtime.

Terminalet e kabllit 20 kV duhet te jene te sigurta edhe kur jane ne ngarkese , nen tension apo nen veprimin e lidhjes se shkurter apo avarive te tjera qe mund te ndodhin ne sistem, ato duhet te sigurojne dhe punojne ne kushte optimale.

### Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje:

- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001
- Te dhena teknike si ne specifikime teknike
- Te gjitha test raportet e fabrikes
- Skicat dhe dimensionet
- Manual I perdorimit
- Te kene marketim CE

### Kushtet e sistemit

#### Te dhena per sistemin

Specifikime	Njesia	
Tensioni nominal ne sistem	kV	20
Tensioni me i larte per paisjet	kV	24
Frekuenca e sistemit	Hz	50
Numri I fazeve		3
Sistemi I tokezimit		I izoluar

#### Kushtet atmosferike

Temperature maksimale e ambientit	40 °C
Temperatura maks. mesatare ditore	30 °C
Temperatura minimale e ambientit	-10 °C
Temperatura maks. ne sipërfaqet e ekspozuara ne diell	60 °C
Lageshtia relative maks ( ne toke )	95 %
Lageshtia relative maks ( ne ajer)	80 %
Lartesia maksimale mbi nivelin e detit	<1000 m

Testet fizike dhe elektrike duhet te jene ne perputhje me standartet IEC ose ekuivalentet e tyre. Materialet duhet te jene sipas standartit ISO 9001 ose nje standart me i avancuar.

### Standartet referuese

Terminalet e kabllit nje dhe terfaze 20 kV duhet te jene conform kerkesave te standartit CENELEC HD 629, EN 50180, IEC 60137 ose ekuivalenete e tyre.



### Testet

Testet duhet te kryhen ne perputhje sic specifikohet ne standartin CENELEC HD 629, IEC 61442 ose standarte te tjera ekuivalente.

### Identifikimi dhe paketimi


Paketimi duhet te jete I projektuar ne menyre te tille qe te mbroje mallin nga hyrja e ujit dhe demtimet mekanike. Te gjitha pjeset perberese duhet te ruajne parametrat teknike ne temperaturat -5°C deri 40 °C. Cdo koke kablli te duhet te kete brenda amballazhimit udhezimet e instalimit, aplikimin, diapazonin e perdorimit si dhe emertimin dhe sasine e pjeseve perberese. Emertimet, diapazoni, emri firmes prodhuese duhet te jete i stamposur mbi cdo pjese perberese.

## A. KOKA KABLLI PER KABLLLOT NJE DEJESH TE EKSPANIZUAR ME IZOLIM POLIMERIK

### 1. Terminale te brendeshem 20 kV

#### Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



#### Pershkrim

Keto specifikime ju perkasin kerkesave per terminale (te termotkurrshem) te brendshme per kablot 1-dejesh te ekranuar XLPE alumini 20 kV.

Trupi I terminalit(I termotkurrshem) duhet te kete nje shtrese kontrolli per te kryer kontrollin e fushes elektrike brenda te gjithe gjatesise se terminalit dhe nje shtrese izolimi ne formen e nje tubi me dy shtresa te stampuara qe ne prodhim per te mos lejuar flluska ajri midis tyre, qe ben te mundur mospasjen e zonave me gradiante te larte te fushes elektrike. Ngjitesin termoshkrires me shkrijen e tij hermetizon skajet e kabllit nga lageshtira dhe papastertite.

Materiali nuk duhet te jete I levizshem, duhet te jete rezistent ndaj erozionit dhe rrezeve ultraviolet. Hermetizimi I plote I kabllit , rrjetes prej bakri realizohet nepermjet perdorimit te mastikes se termotshkrishme ne te dy anet e terminalit. Ngjitesi I termoshkrishem I tubit te jashtem shkrin gjate instalimit dhe dhe mbush poret e kabllit duke u ngjitur me te dhe duke krijuar hermetizim te larte ndaj lageshtise, papastertive etj.

Ai gjithashtu permban nje shirit ne ngjyre te verdhe, i cili mbeshtillet perreth “shtreses gjysem percjellese izoluese”, per te siguruar mos shkarkimin ne kete zone si rezultat i hapësirave me ajer.

Kapikordat ne forme syri duhet te jene prej materiali bimetalik (Al-Cu) dhe te jene brenda kompletit. Me kerkese te vecante ku percaktohet dhe materiali Cu-Al ose Al, kapikordat mund te jene edhe ne forme kunjji,

Bshkueset per lidhjen me token do te porositen te ndara.

Seti I terminaleve te furnizuara duhet te perfshije materialet komplet per gjithe kabllin nje fazor.

### Perdorimi

Terminalet e brendeshme jane ndertuar per kabllot e ekranizuar me nje dell me izolim plastic 20 kV dhe perdoren per ambiente te brendeshme.


### Te dhena teknike per koka kablli 1x----- per ambient te brendshem

Lloji	Vlera e tensionit (kV)	Seksioni terthor I percjellesit te fazes (mm <sup>2</sup> )	L (mm)	Seksioni terthor I percjellesit te fazes (mm <sup>2</sup> )	L (mm)
I	20	25 – 70	340	50 – 150	340
II		70 - 240	340	120 – 240	340
III		185 - 400	340	185 - 300	340
IV		400-800	340	400-630	340

## 2. Terminalet e jashtme 20 kV

### Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



### Pershkrim

Ndertimi dhe instalimi eshte njesoj si tek terminalet e brendeshme.

Bashkueset per lidhjet e tokezimit do te porositen te ndara.

Fustanellat do te instalohen pergjate tubit .(shiko tabelen)

Seti I terminaleve te furnizuara duhet te perfshije materialet komplet per gjithe kabllin nje fazor.

**Perdorimi**

Terminalet e jashtme jane ndertuar per kabllot e ekranizuar me nje dell me izolim plastic 20 kV perdoren per ambient te jashtem.

**Te dhena teknike per koka kablli 1x----- per ambient te jashtem**

Lloji	Vlera e tensionit (kV)	Seksioni terthor I percjellesit te fazes (mm <sup>2</sup> )	L (mm)	D (mm)	Nr.i dejeve dhe fustanellave per 1 dell (cope)
I	20	25 – 70	440	85	3x3
II		70 – 240	440	95	3x3
III		185 - 400	440	115	3x3
IV		400-800	440	115	3x3

				Date, seal and Signature of Tenderer:
<b>Lista e te dhenave (DATA SCHEDULES )</b>				
ITEM	Pershkrimi (DESCRIPTION)	UNIT	required	func. Guarantee
<b>I</b>	<b>Koka kablli TM (MV Termination)</b>			
<b>1</b>	<b>Te dhena te pergjitheshme (GENERAL DATA)</b>			
1.1	Standarti aplikuar (Applied standard)			
1.2	Prodhuesi (Manufacturer)			
1.3	Tipi (Termination type)			
1.4	Tensioni nominal (Rated voltage)	kV		
	Aplikimi (Application)			
1.5	Numri dejeve (Number of cores)	pcs		
	Numri skajeve (Number of skirts)	pcs		
1.6	Seksioni i kokes (Cross section of the termination)	mm <sup>2</sup>		
1.7	Diametric kokes (Diameter of the termination)	mm		
1.8	Gjatesia e kokes (Length of the termination )	mm		
1.9	Tipi kapikordes (Type of the lug)			
1.10	Materiali kapikordes (Material of the lug)			
1.11	Seksioni i kapikordes (Cross section of the lug)	mm <sup>2</sup>		
1.12	Gjatesia e kapikordes (Length of the lug)	mm		

Me qene se termat jane teknike, baze do te jete emertimi ne anglisht.

# **SPECIFIKIME TEKNIKE**

## **KOKA(TERMINALE) KABLLI TU**

## SPECIFIKIME KOKA(TERMINALE) KABLLI TU

### Te pergjithshme

Te gjitha terminalet e kabllit TU jane projektuar qe te jene te sigurta ne kushte klimatike te ndryshme pa pesuar demtime.

Terminalet e kabllit duhet te jene te sigurta edhe kur jane ne ngarkese , nen tension apo nen veprimin e lidhjes se shkurter apo avarive te tjera qe mund te ndodhin ne sistem, ato duhet te sigurojne dhe punojne ne kushte optimale.

### Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje:

- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001
- Te dhena teknike si ne specifikime teknike
- Te gjitha test raportet e fabrikes
- Skicat dhe dimensionet
- Manual I perdorimit
- Te kene marketim CE

### Kushtet e sistemit

#### Te dhena per sistemin

Specifikime	Njesia	Sistemi
Tensioni nominal ne sistem	kV	0.4/0.23
Tensioni me I larte ne sistem	kV	0.66
Frekuenca e sistemit	Hz	50
Numri I fazeve		3 faze/4 percjelles
Sistemi I tokezimit		I izoluar

#### Kushtet atmosferike

Temperature maksimale e ambientit	40 °C
Temperatura maks. mesatare ditore	30 °C
Temperatura minimale e ambientit	-10 °C
Temperatura maks. ne siperfaqet e ekspozuara ne diell	60 °C
Lageshtia relative maks ( ne toke )	95 %
Lageshtia relative maks ( ne ajer)	80 %
Lartesia maksimale mbi nivelin e detit	deri 1000 m

Testet fizike dhe elektrike duhet te jene ne perputhje me standartet IEC ose ekuivalentet e tyre.

Materialet duhet te jene sipas standartit ISO 9001 ose nje standart me i avancuar.

### **Standartet referuese**

Terminalet e kabllit duhet te jene conform kerkesave te standartit CENELEC HD 629, IEC 60093, IEC 60216, IEC 60243 ose ekuivalenete e tyre.

### **Testet**

Testet duhet te kryhen ne perputhje sic specifikohet ne standartin CENELEC HD 629, ose standarte te tjera ekuivalente.

### **Koke kablli per kabell TU me 4 deje**

#### **Ilustrim**

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



#### **Pershkrim**

Kablli duhet te transformohet ne pothuaj kater deje kablli te cilat lejojne kryqezimin e dejeve madje dhe ne hapësirat e mbyllura te lidhjes. Ne 4 dejet e hapura te kabllit futen tuba izolues me termotkurje per mbrojtjen ndaj shkarkimeve siperfaqesore(nje per cdo dell). Tubat te jene te veshur nga brenda me ngjitesin termoshkrires , i cili gjate nxehjes shkrin dhe ngjitet me dejet e kabllit duke siguruar hermetizim te larte. Per hermetizimin e kapikordave me percjellesin duhet te kete nga nje tub me termotkurje te shkurter me ngjites nga brenda. Kapikordat e perdorura ne keto terminale duhet te jene me hermetizim gjatesor.Ne piken ku dejet ndahen vendoset materiali bllokues dhe ngjites(gushorja me kater gishteza). Ngjitesi termoshkrires me shkrirjen e tij hermetizon skajet e kabllit me gushoren nga lageshtira dhe papastertite. Gushorja ben hermetizimin e gjithe kabllit.

Kapikordat ne forme syri se bashku me bullonat jane brenda kompletit .

Te gjitha materialet e perdorura duhet te kene:

- Qendrueshmeri te larte në mjedise acide dhe alkaline

- Rezistencë të lartë ndaj rrezatimit ultraviolet.

Seti I terminaleve te furnizuara duhet te perfshije materialet per te tre fazet dhe per neutrin. Gjatesite e dejeve te jene 450 mm dhe mund te reduktohen ne varesi te kerkeses se vendit ku instalohen,

### **Te dhena teknike**

Kokat e kabllit do te jene tre tipe: per seksion te kabllit :

4x25 – 4x95 mm<sup>2</sup>,

4x50-4x150 mm<sup>2</sup>,

4x120 – 4x400 mm<sup>2</sup>.

Qendrushmeria dielektrike 14 kV/mm.

**Paketimi:** Kuti kartoni.

### **Koke kablli per kabell TU me 1 dell**

#### **Ilustrim**

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



#### **Pershkrim**

Ne dellin e kabllit futet tub izolues me termotkurje per mbrojtjen ndaj shkarkimeve siperfaqesore. Tubi te jete i veshur nga brenda me ngjitesin termoshkrires , i cili gjate nxehtes shkrin dhe ngjitet me kabllin duke siguruar hermetizim te larte. Per hermetizimin e kapikordave me percjellesin duhet te kete nje tub me termotkurje te shkurter me ngjites nga brenda. Kapikordat e perdorura ne keto terminale duhet te jene me hermetizim gjatesor. Ne zonen midis veshjes se kabllit dhe dellit te kabllit vendoset materiali bllokues dhe ngjites(gushorja). Ngjitesi termoshkrires me shkrirjen e tij hermetizon skajet e kabllit me gushoren nga lageshtira dhe papastertite. Gushorja ben hermetizimin e gjithe kabllit.

Kapikorda ne forme syri se bashku me bullonin dadon dhe rondelet jane brenda kompletit.

Te gjitha materialet e perdorura duhet te kene:

- Qendrushmeri te larte në mjedise acide dhe alkaline

- Rezistencë të lartë ndaj rrezatimit ultraviolet.

Gjatesite e dejeve te jene 450 mm dhe mund te reduktohen ne varesi te kerkeses se vendit ku instalohen,

**Te dhena teknike**

Kokat e kabllit do te jene tre tipe: per seksion te kabllit:

1x25-1x95 mm<sup>2</sup>,

1x50-1x150 mm<sup>2</sup>,

1x95-1x500 mm<sup>2</sup>.

Qendrueshmeria dielektrike 14 kV/mm.

**Paketimi:** Kuti kartoni.



# **SPECIFIKIME TEKNIKE**

## **KOKA FUNDORE**

## a- KOKE FUNDORE PREJ GOME

### Ilustrimi



### Pershkrimi, Kerkesa, Te dhena

Kokat fundore prej gome sherbejne per te izoluar skajet e percjellesave te izoluar, me qellim qe te mos lejojne futjen e lageshtires brenda tij. Forma e tyre eshte konike . Vendosen ne fund te percjellesit me perdredhje duke e izoluar plotesisht skajin e tij nga ambient I jashtem.

Ato perbehen prej materiali termoplastik dhe jane rezistente ndaj rezatimit Ultra Violet.

Testohen plotesisht ne tension 6kV dhe nen kushtet e ujit.

Duhet te jene ne perputhje me standartet IEC ose ekuivalenteve te tyre si psh NFC 33 020

### Te dhena teknike


Seksioni terthor I dellit (mm <sup>2</sup> )
6-35
16-150

### Paketimi

Paketothen ne kuti kartoni

## b. KOKE FUNDORE ME TERMOTKURJE PER IZOLIMIN E SKAJEVE TE PERCJELLESAVE OSE KABLLOVE

### Ilustrimi



### Pershkrimi, Kerkesa, Te dhena

Kokat fundore me termotkurje sherbejne per te izoluar skajet e kablllove ose dejeve gjat kohes se magazinimit, trasportit apo per nevoja te tjera.

Ata realizojnë:

- Izoliminm elektrik
- Qendrushmeri të lartë mekanike ndaj mjedisit të jashtëm
- Qendrushmeri të lartë në mjedise acide dhe alkaline
- Rezistencë të lartë ndaj rrezatimit ultraviolet.
- Duhet të jetë i veshur nga brenda me lëndë ngjitëse termo-tkurrëse, e cila, duke u shkrirë gjatë nxehtësisë, duhet të realizojë ngjitjen e veshjes izoluese te kabllit ose me dejet e kabllit duke bere keshtu hermetizimin e tyre ndaj te gjithë agjenteve atmosferike

Duhet te jene ne perputhje me standartet IEC ose ekuivalenteve te tyre.

### Te dhena Teknike

Diametri i percjellesit ose kabllit (mm)	Dimensionet			
	D		L	W
	a(min)	b(max)	b(±10%)	b(±20%)
4-8	10	4	38	2.0
8-17	20	7.5	55	2.8
17-30	35	15	90	3.2
30-45	55	25	143	3.9
45-65	75	32	150	3.3
65-95	100	45	162	3.8

Da- Diametri fillestar para ngrohjes

Db- Diametri pas ngrohjes

Lb- Gjatesia pas ngrohjes

Wb- Trashesia(spesori pas ngrohjes)

### Paketimi

Paketoheh ne kuti kartoni.

# **SPECIFIKIME TEKNIKE**

## **KONSTRUKSIONE METALIKE**

## KONSTRUKSIONE METALIKE

Ky specifikim perfshtin rregullat e pergjithshme per pregatitjen e konstruksioneve metalike.

Konstruksionet do te prodhohen ne baze te vizatimeve perkatese.

Te gjitha materialet e perdorura duhet te jene te galvanizuara ne te nxehte dhe te plotesojne kerkesat e standarteve IEC ose atyre ekuivalente me to.

### A- MATERIALET

#### PROFILE CELIKU

##### Pershkrimi

Profilet e celikut perftohen nga perpunimi ne te nxehte i hekurit. Ato jane me te buta se perpunimi ne te ftohte.

Ato duhet te plotesojne te gjitha kerkesat e standarteve ASTM A 123/A, 123M dhe A 153/A, 153M.


Gjatesia eshte 6 metra ose sipas kerkeses

##### Te dhena teknike

#### PROFILE CELIKU “L”DHE “U” TE ZINGUARA

##### Illustrimi

(Orientues)



Specifikime teknike

Keto prodhohen te galvanizuara ne te nxehte.

**Profilet kendore ne forme "L"**

Gjatesia e brinjës se profilit (mm)	Trashësia (mm)	Pesha e perafert (kg/m)	Gjatesia e brinjës se profilit (mm)	Trashësia (mm)	Pesha e perafert (kg/m)
20	3	0.88	70	7	7.38
25	3	1.11	70	9	9.34
25	4	1.45	75	7	7.94
30	3	1.35	80	8	9.66
30	4	1.77	80	10	11.90
35	3	1.61	90	9	12.20
35	4	2.10	100	10	15.10
40	3	1.86	100	12	17.80
40	4	2.42	110	10	16.60
40	5	2.97	120	12	21.60
45	5	3.38	140	14	29.50
45	6	4.00	150	12	27.30
50	5	3.77	150	15	33.80
50	6	4.47	160	15	36.20
50	7	5.15	180	16	43.50
55	5	4.18	180	18	48.60
60	6	5.42	200	16	48.50
60	8	7.09	200	20	59.90

**Profile "U"**

a (mm)	b (mm)	Trashësia s (mm)	Pesha e perafert (kg/m)	a (mm)	b (mm)	Trashësia s (mm)	Pesha e perafert (kg/m)
30	15	4.0	1.74	160	65	7.5	18.80
40	20	5.0	2.87	180	70	8.0	22.00
40	35	5.0	4.87	200	75	8.5	25.30
50	25	5.0	3.86	220	80	9.0	29.40
50	38	5.0	5.59	240	85	9.5	33.20

## Specifikime teknike

60	30	6.0	5.07	260	90	10.0	37.90
65	42	5.5	7.09	280	95	10.0	41.80
80	45	6.0	8.64	300	100	10.0	46.20
100	50	6.0	10.60	320	100	14.0	59.20
120	55	7.0	13.40	350	100	14.0	60.60
140	60	7.0	16.00				

**B- PRODHIMI I KONSTRUKSIONIT****Cilesia e prodhimit**

Prodhimi i te gjithave materialeve duhet te behet ne perputhje me specifikimet.

Cilesia e prodhimit duhet te jete ne çdo element shume e mire. Te gjitha pjeset duhet te jene te drejta sipas vizatimit te detajuar dhe pa difikte. Te gjitha punimet, si prerjet, perkuljet, vrimat e bulonave etj. duhet te jene sipas vizatimit perkates te detajuar dhe pa gervishtje.

Kontraktori duhet te jete pergjegjes per montimin e duhur te te gjitha pjeseve. Ai eshte i detyruar te nderoje pa kosto shtese te gjithë elementet e demtuar qe zbulohen gjate montimit dhe te paguaje koston e zevendesimit te tyre.

Te gjitha pjeset e struktures do te jene te mbaruara me cilesi te larte. Te gjitha pjeset e prodhuara duhet te jene ne perputhje te plote me projektet e realizuara nga kontraktori dhe te aprovuara nga Punedhënesi.

**Ndarjet dhe prerjet**

Te gjitha elementet ne forme "L" ne fundet e tyre mund te priten drejt ose me kend me te vogel se 90° per te mos penguar njeri tjetrin gjate montimit, por me kusht tensionimi te mos transmetohet ne keto pjese dhe vrima e bulonit duhet te plotesoje distancen e lejuart nga fundi i elementit.

E njejta gje mund te thuhet edhe nese prerjet me kend ne njerën faqe te elementit behet me djegie ne temperature te larte.

**Hapja e vrimave me punkcion dhe punto**

Te gjitha vrimat e bulonave ne elementet e konstrukcionit duhet te realizohen me punkcion me anen e makinerive perkatese ose te hapen me punto para galvanizimit. Vrimat ku kapet percjellesi duhet te hapen vetem me punto.

Te gjitha elementet duhet te pastrohen nga mbetjet pas hapjes se vrimave.

## Specifikime teknike

---

Te gjithë elementet qe kane vrime ose prerje me gabim me shume se 0.8 mm nuk do te pranohen. Nuk do te lejohet asnje saldim, mbushje ose mbyllje e ketij gabimi vetem nese Punedhënesi e aprovon.

Hapja e vrimave me punction do te ndjeke limitet e meposhtme. Ne listen e meposhtme, vrimat me punto do te hapen me diameter te plote ose ato hapen fillimisht me punction me diameter 4 mm me te vogel se diametri i plote i kerkuar:

- a) Per te gjithë elementet me trashesi te barabarte ose me shume se 14 mm;
- b) Celik me fortësi te larte me trashesi te barabarte ose me te madhe 10 mm ;
- c) Vrimat ne afersi te kendeve te eleve ose te pllakave kendore;
- d) Vrimat ne elet e traversave te ngarkuara normalisht per keto lloje celiku S235 & S355 sipas standartit EN-10025 ose ndonje standarti ekuivalent me te.

Te gjitha vrimat qe do jene te zgjatura ose te perkulura nuk do te pranohen.

Diametri i vrimave do te jete 13.5, 17.5, 21.5 dhe 26 mm per bulonat respektive 12, 16, 20 dhe 24 mm, per diametra me te medhenj vrime duhet te hapet 2.0 mm me e madh se diametri i bulonit.

Perputhja e vrimave te elementeve qe bashkohen duhet te mos kene shmangje dhe buloni duhet te kaloje lirisht ne to..

Taposja e vrimave duhet te kenaqi kerkesat e standarteve bashkekohore.

### **Perkuljet**

Te gjitha perkuljet e elementeve prej celiqeve me fortësi te madhe do te realizohen ne te nxehte. Perkuljet e nje natyre te veshtire do te behen ne te nxehte, por mund te pranohet edhe ne te ftohte.

Perkulja ne te nxehte e te gjithë elementeve do realizohet me nje flake jo oksiduese mbi nje siperfaqe te mjaftueshme per te eliminuar deformimin e tepert. Perkuljet me te nxehte do te lihen te ftohen me ngadale ne temperaturën e ambientit.

Te gjitha perkuljet duhe te plotesojne kerkesat sipas standartit.

### **Saldimi**

Te gjitha saldimit e mundshme do te behen ne perputhje te plote me standartin EN 1993-1-1 ose standarte te tjera ekuivalente.

Nje procesin e saldimit duhet te perdoret mburoja nga harku i saldimit. Te gjitha saldimit do te plotesojne me korektesi kerkesat teknike per kete proces pune. Procesi i saldimit dhe saldatori duhet te jete kualifikuar sipas kerkesave te permendura ne standardin EN 1993-1-1, ose DIN 18800-7 ose ekuivalente. Struktura prej çeliku, procesi saldim, elektroda dhe trajtimi duhet te jete i tille qe te shmangent demtimi i çelikut dhe te garantohet nje operimin e sigurt ne temperatura te uleta



### **Tolerancat**

Tolerancat per elementet e perfunduar do te jene si me poshte:

- a) Elementet e perfunduar nuk duhet te kene luhatje anesore me te medha se  $1/1000$  e gjatesise aktuale ndermjet pikave te mbeshetjeve anesore.
- b) Per elementet e perfunduar te gjate deri ne 3 m do te lejohet tolerance  $\pm 1.5\text{mm}$ . Per çdo element me te gjate se 3 m do te shtohet 1 mm tolerance per çdo 3 m gjatesi, por ne asnje rast nuk do lejohet me shume se 3 mm tolerance per çdo element.

### **Mbrojtja nga korozioni**

Te gjithë elementet e konstruksionit perfshire dhe aksesoret duhet te mbrohen nga korozioni i vashdushem me galvanizim ne te nxehte.

### **Standrtet**

- DIN EN 1990 Eurokodi - Bazat e projektimit strukturor (Eurocode: Basis of structural design)
- DIN EN 1992-1-1 Eurokodi 2: Projektimi i strukturave të betonit - Pjesa 1-1: Rregullat e përgjithëshme dhe rregullat për ndërtesat Eurocode 2: Design of concrete structures - Part 1-1: General rules and rules for buildings
- DIN EN 1993-1-1 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1-1: Rregullat e përgjithëshme dhe rregullat për ndërtesat (Eurocode 3. Design of steel structures General rules and rules for buildings)
- DIN EN 1993-1-2 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1- 2: Rregullat e përgjithëshme - Projektimi strukturor për zjarrin (Eurocode 3: Design of steel structures - Part 1-2: General rules - Structural fire design)
- DIN EN 1993-1-4 Eurokodi 3 - Projektimi i strukturave të çelikut - Pjesa 1-4: Rregulla të përgjithëshme - Rregulla shtesë për çeliquet e paoksidueshëm (Eurocode 3: Design of steel structures - Part 1-4: General rules - Supplementary rules for stainless steels)
- DIN EN 1993-1-5 Eurocode 3 - Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1-5: Elementët strukturor pllakë (Design of steel structures - Part 1-5: Plated structural elements)
- DIN EN 1993-1-6 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1-6: Rezistenca dhe stabiliteti i strukturave guackore (Eurocode 3 - Design of steel structures - Part 1-6: Strength and Stability of Shell Structures)

- DIN EN 1993-1-8 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1- 8: Projektimi i xhuntimeve (Eurocode 3: Design of steel structures - Part 1-8: Design of joints)
- DIN EN 1993-1-10 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1-10: Rezistenca e materialit dhe vetitë nëpërmjet trashësisë (Eurocode 3: Design of steel structures - Part 1-10: Material toughness and through-thickness properties)
- DIN EN 1993-1-11 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku - Pjesa 1-11: Projektimi i strukturave me komponentë në tërheqje (Eurocode 3: Design of steel structures - Part 1-11: Design of structures with tension components )EN 1994-1-1 Design of composite steel and concrete structures – General rules and rules for buildings
- DIN EN 1994-1-2 Eurokodi 4: Projektimi i strukturave kompozite çelik dhe beton - Pjesa 1-2: Rregulla të përgjithshme – Projektimi strukturor ndaj zjarrit(Eurocode 4: Design of composite steel and concrete structures - Part 1-2: General rules - Structural fire design)EN 1998-1 Design of structures for earthquake resistance – General rules, seismic actions and rules for buildings
- DIN EN 1998-5 Eurokodi 8: Projektimi i strukturave rezistente ndaj tërmetit - Pjesa 5: Themelet, strukturat mbajtëse dhe aspekte gjeoteknike(Eurocode 8: Design of structures for earthquake resistance - Part 5: Foundations, retaining structures and geotechnical aspects)

## Specifikime teknike

---

# **SPECIFIKIME TEKNIKE PER MATERIALE PER TOKEZIME**

## **TE PERGJITHESHME**

Te gjitha materialet feromagnetike te me poshtme(perfshire pjeset perberese), perjashtuar rastet kur specifikohet, do te jene celik I galvanizuar ne te nxehte me trashesi jo me te vogel se 60µm. Ilustrimi dhe dimensionet janë orientuese.

### **I. TOKËZIMI**

#### **a2. Shirit celiku**

##### **Përshkrimi Teknik**

Shiriti prej çeliku të zinkuar përbëhet nga një shirit çeliku i zhveshur mbuluar me një shtresë zinku me trashësi jo më pak se 70µm ( 500gr/m<sup>2</sup>)

##### **Zbatimi**

Përcjellësit shirit prej çeliku të galvanizuar shërbejnë për tokëzimin e pajisjeve si përcjellës tokëzimi.

##### **Kërkesat e instalimit**

Temperatura minimale e lejuar e mjedisit duhet të jetë -20 ° C.

Gjatë transportit dhe montimit, rrota me shirit çeliku të zhveshur duhet të vendoset me kujdes në mënyrë që shtresa e zinkut të mos dëmtohet.

Gjatë përdorimit të tij për tokëzimin e pajisjeve, shiriti i çelikut i zhveshur çmbështillet me kujdes.

Bashkimi me elementët e tjerë të tokëzimit realizohet përmes morsetave përkatëse.

**Mjedisi:** ambjente të jashtme dhe nëntokë

##### **Ruajtja, trajtimi dhe transporti**

Paketimi i shiritit të çelikut të zinkuar bëhet në rrota, duke fiksuar spiralet me shirita izoluese, në mënyrë që ato të mos çmbështillen dhe të mos dëmtohet shtresa e zinkut. Gjatë transportit, këto rrota me shirit çeliku të zinkuar duhet të sigurohen ndaj lëvizjeve të padëshiruara.

Temperatura e rekomanduar e ruajtjes varion nga -25 °C deri në + 70 °C.


Gjatë ruajtjes për një kohë të gjatë, rekomandohet që rrotat të mbrohen nga faktorët e jashtëm, duke i vendosur nën një tendë ose duke mbështjelle me mushama për t'i mbrojtur nga uji.

##### **Të dhëna teknike**

##### **Ilustrim:**

(Ilustrimi dhe dimensionet janë orientuese)

Specifikime Teknike - Tokezime




**Parametra Teknike**

Përmasat	Sipërfaqja	Materiali	Pesha
mm	mm <sup>2</sup>		kg/km
20x2.5	50	St/Zn	400
25x4	100	St/Zn	800
30x3.5	105	St/Zn	840
30x4	120	St/Zn	960
40x4	160	St/Zn	1250
40x5	200	St/Zn	1670

**a. Elektrodat e tokëzimit**

**Ilustrimi**

Specifikime Teknike - Tokezime



### Përshkrimi, Kërkesat dhe Të Dhënat

Ky specifikim mbulon kërkesat për elektrodën e sistemit të tokëzimit. Pjesë perberese e electrodes është edhe morseta sipas detajit “A”

### TË DHËNA TEKNIKE

Formë kryqi “+” jo më pak se 50x5mm, H=1.5 ose 2.0m, që nuk shtrihet/zgjatet  
Cilësia e çelikut DIN 17 100  
Pajisur me pllakë bashkuese  
Paisur me morseten për bashkimin me percjellesin me diametër deri 13mm  
I përputhshëm me DIN 48 – 452  
Shtresë zinku – minimumi 70 mikron.

### Identifikimi dhe Paketimi

Elektrodat do të paktohen në kuti kartoni (10 copë).

Çdo kuti do të përmbajë informacion për:

- llojin e elektrodës

Specifikime Teknike - Tokezime


- përmasat e elektrodës
- prodhuesin
- vitin e prodhimit
- pesha bruto
- numrin e kutisë

**b. Shkeputes tokezimi per percjellesin e tokezimit**

**c1. Morsete universale**

**Ilustrimi**

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



Morseta eshte e perbere prej materiali me nje qendrueshmeri shume te larte i cili eshte veshur me nje shtrese anti korrozive zinku me nje trashesi 60 mikron.

Morseta shtrengohet fort me bulona te cilet kane nje shtrese anti korrozive.

Bulonat dhe rondelet jane prej celiku te galvanizuara ne te nxehte

**Te dhena teknike**


Dimensionet		[mm]	diam. percjellesit	Forca e lidhjes(qendrushmerise)
a	b	M	[mm]	[kN]
50	40	10	2.7-9.4	4.6

**Ilustrimi**

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



Specifikime Teknike - Tokezime



Dimensionet mm			diam. percjellesit	Momenti perdredhjes Nm	F. e lidhjes(qendru shmerise) kN
a	b	c			
52	61	56.4	9-16	45	13.26


Morseta eshte e perbere prej materiali me nje qendrueshmeri shume te larte i cili eshte veshur me nje shtrese anti korrozive zinku me nje trashesi 60 mikron.  
Morseta shtrengohet fort me bulona te cilet kane nje shtrese anti korrozive.  
Bulonat dhe rondelet jane prej celiku te galvanizuara ne te nxehte

## c2. Shkeputes shirit

### c.2.1. Shkeputes shirit - shirit

#### Ilustrimi

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



#### Te dhena teknike


Shirit (mm)	L (mm)	L1 (mm)	C (mm)	M1	M	Pesha (kg)
25x4	80	66	50	M10x30	M12x30	0.33

Materiali i shkeputesit, bulonat,dadot, rondelet jane prej celiku te galvanizuar ne te nxehte sipas DIN 17100.  
Shkeputesi do te lidhe shiritin e galvanizuar ne te nxehte 25x4 mm me shiritin 25x4 mm.

**c.2.2. Shkeputes litar - shirit**

**Ilustrimi**

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



**Te dhena teknike**

Shirit &Litar (mm)	L (mm)	L1 (mm)	C (mm)	S (mm)	M	Pesha (kg)
40x4 Max. D-12	60	60	40	4	M6x30	0.25

Materiali i shkeputesit, bulonat,dadot, rondelet jane prej celiku te galvanizuar ne te nxehte sipas DIN 17100.


Shkeputesi do te lidhe litarin e galvanizuar ne te nxehte me diameter D 25x4 mm me shiritin 40 x4 mm.

**c.2.3. Morsete tokezimi per bashkim shirit-shirit**

**Ilustrimi**

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)

Specifikime Teknike - Tokezime



**Te dhena teknike**

Shirit (mm)	L (mm)	L1 (mm)	C (mm)	S1 (mm)	S2 (mm)	M
25x4	60	60	40	4	4	8
25x4	60	60	40	4	4	10
40x4	80	80	60	4	4	8
40x4	80	80	60	4	4	10

Te gjitha pjeset perberese jane prej celiku te galvanizuar ne te nxehte

**c. Fiksues per percjellesin e tokezimit ne faqe te murit ose beton**

**Tipi per fiksimin e percjellesit shirit**

**Ilustrimi**

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



Sherben per fiksimin e percjellesit te tokezimit forme shiriti ne faqe te murit ose betone. Madhesia maksimale e shiritit qe fiksohet eshte 40x4mm. Bullonat shtrengues jane M6x16mm. Ne pjesen e fiksimit, fiksuksi ka dado me fileto M8mm , e pershtatsheme per montim ne up plastik universal me vide me koke me fileto metrike. Dy pjastrat fiksuksue kane spesor 3 mm secila. Te gjitha materialet jane celik te galvanizuar ne te nxehte.

**Tipi per fiksimin e percjellesit te rumbullakte**

**Ilustrimi**

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)




Sherben per fiksimin e percjellesit te tokezimit te rumbullaket ne faqe te murit ose betone. Diametri maksimal i percjellesit qe fiksohet eshte 8-12mm. Bullonat shtrengues jane M6x16mm. Ne pjesen e fiksimit, fiksuesi ka dado me fileto M8mm , e pershtatsheme per montim ne up plastik universal me vide me koke me fileto metrike. Pjastrat fiksuse kane spesor 3 mm. Te gjitha materialet jane celik te galvanizuar ne te nxehte.

### Upa plastik universal me vide me koke me fileto metrike

#### Ilustrim

(Ilustrimi eshte orientues)



#### Pershkrim

Upi plastik është bërë nga material polyamid 6, dhe buloni është bërë nga çelik i galvanizuar (zingu i bardhë). Në raste të veçanta buloni mund të bëhen prej bronzi. Koka e bulonit eshte me fileto metrike.

#### Applikimi

Perdoret per fiksimin e elementeve te ndryshem ne sipërfaqet e mureve, ne dysheme, tavan e tje.


#### Te dhena Teknike

Tipi (mm)	Punto Ø (mm)	Gjatesia e ankorimit	Thellesia minimale e cpimit (mm)	Filetua e kokes bulonit x gjatesia pjeses filetuar (mm)
	$d_0$	1	$h_0$	
6x35	6	35	45	M6x12
8x35	8	35	45	M8x15

#### d. Kapikordat Al-Cu per kabllin TU

##### Ilustrim

(Ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



##### Përshkrimi, Kërkesat, Të Dhënat.

Ky specifikim mbulon të kërkesat për kapikorda për:

- Litar alumini, me sipërfaqe të prerjes tërthore 95 mm<sup>2</sup>.

Kapikordat do të prodhohen sipas Standardeve IEC ose standardeve të tjera ekuivalente.

##### Ndertimi dhe Materiali.

Kapikordat duhet të jenë të përshtatshme për përdorim në përcjellesat litar.

Kapikordat do të përdoren për lidhjen e përcjellesave litar me paisjet.

Kapikordat, në pjesën ku futet përcjellesi do të jetë alumini. Fiksimi i përcjellesit bëhet me presim.

##### Të dhëna teknike

Kapikorda Alumin - Baker	Njësia	Vlera e kërkuar
Tensioni nominal	kV	0,6/1
Seksioni I përcjellësive	mm <sup>2</sup>	95
Numri i fazave		3 faze
Frekuenca	Hz	50

Seksioni I përcjellesit (mm <sup>2</sup> )	Dimensionet (mm)			
	D	D1	D2	L
95	22	13.5	13	90.5

##### Testi

Testet fizike dhe elektrike të materialit do të kryhen në përputhje me Standartin IEC 220 ose ekuivalentit të tij.

**e. Fashetat vetblokuse prej celiku per fiksimin e mbrojtases ne shtylle**



Fashetat vetblokuse prej celiku 0.25x12x1200mm , per fiksimin e mbrojtases ne shtylle duhet:

Tekete nje mekanizem vetblokus qe lejon perdorim te lehte dhe te shpejte,  
Qendrushermeri te larte ne terheqeje,  
Elasticitet te larte,  
Te jete zjarduruse,  
Te kete qendrushermeri te larte ndaj agjenteve atmosferike, korozionit si dhe acideve dhe bazave te ndryshme.  
Materiali: celik inoksitabel # 316


Fashetat vetblokuse prej celiku per fiksimin e mbrojtases ne shtylle duhet te siguroje mbyllje te sigurte dhe te qendrueshme. Ajo perdoret ne ambiente te brendeshme dhe te jashtme.

**j. Kapikorda tubolare Alumini me presim**

Kapikordat tubolare prej alumini prodhohen nga tubot e aluminit ne perputhje me standartin EN 50182  
Ato duhet te jene rezistente ndaj korozionit, rezatimit UV. Ne to duhet te shenohet vendet e presimit

**Ilustrimi**

(Ilustrimi dhe dimensioned jane orientuse)



**Te dhena teknike**

Seksioni I percjellesit (mm <sup>2</sup> )	Dimensionet (mm)					Numri I presimeve cop		Pesha per 100 cop (kg)
	a	L	D	D1	D2	mekanik	hidraulik	

Specifikime Teknike - Tokezime


95	56	90	22	13	13	6	3	6.35
120	58	91	22.5	15	13	6	3	6.70
150	60	103	25	16.5	17	6	3	9.00

Kapikordat prodhohen ne perputhje me standartet IEC ose ekuivalentet e tyre.

**k. Nyje lidhese e izoluar per lidhjen e percjellesit te linjes ABC me percjellesa te cveshur**

**Ilustrimi**

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



**Pershkrimi dhe perdorimi**

Kjo nyje eshte projektuar per te realizuar lidhjen elektrike te linjes me percjelles alumini me vetembajtje(linja ABC) me percjellesa te cveshur (Al, Cu e tje).

Kjo nyje eshte nje kombinim midis nyjeve te izoluar te zakonshme te linjave ABC dhe morsetave qe perdoren per linjat ajrore me percjellesa te cveshur. Bulloni shtrengues duhet te jete i paisur me kapuc izolues.

Gjate shtrengimit te bulonit “dhembet” qe jane ne pjesen ku futet percjellesi i linjes ABC, duhet te levizin drejt percjellsave te izoluar, diametralisht poshte dhe lart, duke u futur fillimisht ne pjesen e izolimit te percjellsave, duke e depertuar ate dhe pastaj ne brendesi te materialit te percjellsave.

Rezistenca e kontaktit qe realizohet duhet te jete ne temperaturen 20 °C jo me i madh se 265 mikro Ohm, por jo me e madhe se 0.815 e vleres se rezistences se percjellesit. Gjithashtu ky shtrengim nuk duhet te zvogeloje qendrushmerine mekanike te percjellsave.

Ndersa pjeset paralele ku futet percjellesi i cveshur, gjate shtrengimit te bulonit, levizin edhe ato diametralisht poshte dhe lart njesoj si te morsetat e zakonshme qe perdoren ne percjellesat e cveshur duke realizuar nje rezistence kontakt me vlerat qe u permenden me lart . Ne rastin kur perdoren per percjellesa Al, te dy pjeset e sipermja dhe e poshtmjane jane te perbera prej aliazhi alumini me qendrushmeri te larte. Ne rastin kur perdoren per percjellesa Cu, ato jane perbere prej bakri te paster elektrolitik .

**Te dhena teknike**

Seksioni i percjellesit(mm <sup>2</sup> )		Buloni	Momenti i shtrengimit(Nm)
Percjellesi i cveshur	Percjellesi i linjes ABC		
16-95	16-95	2xM8	16

Specifikime Teknike - Tokezime

---




# **SPECIFIKIME TEKNIKE**

## **MUFTE KABLLI TU ME 4 DEJE**

## MUFTE KABLLI TU ME TERMOTKURRJE

### Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensioned jane orientuese)



### 1. Te pergjitheshme

Ky specifikim percakton kerkesat per prodhimin, furnizimin dhe testimin e mufteve me termotkurrje per perdorim ne rretin e tensionit te ulet ne ambient te brendshem, te jashtem apo nen toke. Ky material mbulon specifikimet teknike duke perfshire:

- Mufte TU me termotkurrje

### 2. Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje:

- ✓ Certifikatat e prodhuesit ISO 9001
- ✓ Te dhena teknike te kerkuara dhe specifikime teknike
- ✓ Te gjitha test raportet e fabrikes
- ✓ Skicat me dimensione
- ✓ Manual te instalimit
- ✓ Te kene marketim CE

### 3. Kushtet e sistemit

a	Te dhena per sistemin	Unit	Value
1	Tensioni me I larte i sistemit	kV	0.66
2	Tensioni nominal	V	400
3	Frekuenca	Hz	50
4	Numri I fazeve	Nr	3 faze/4percjelles
5	Sistemi I tokezimit		Direkt ne toke

b	Kushtet atmosferike	
1	Temperatura maks. e ambientit	40°C
2	Temperatura min. e ambientit	-10 °C
3	Lageshtia relative maks.	80%
4	Lartesia maks nga niveli I detit	1000m

#### 4. Përshkrim, kërkesa dhe te dhëna

Konstruksioni i muftëve duhet të rigjenerojë elektrikisht dhe mekanikisht konstruksionin e vet kabllit. Muftet e tensionit të ulët janë të perbera nga katër tuba të brendshëm me termotkurje dhe një të jashtëm po me termotkurje. Bashkueset (gizat me bulon) realizojnë lidhjen elektrike të përcjellesave. Koka e bulonit duhet të keputet kur arihet shtrengimi i duhur. Tubat izolues të brendshëm duhet të jenë të veshur nga brenda me lëndë ngjitëse termo-tkurrëse, e cila, duke u shkrirë gjatë nxehtësisë, duhet të realizojë ngjitjen e veshjes izoluese me dejet e kabllit. Tubi i jashtëm me termotkurje dhe ngjitje duhet të jetë i veshur nga brenda me lëndë ngjitëse termo-tkurrëse, e cila, duke u shkrirë gjatë nxehtësisë, duhet të realizojë ngjitjen e veshjes izoluese me mbulesën e jashtme të kabllit.

Struktura kristallore e veshjeve izoluese duhet të lejojë përdorimin e temperaturave sa më të larta gjatë realizimit, si edhe njëkohësisht t'i përgjigjet njëllorë zgjerimit termik të vetë kabllit gjatë shfrytëzimit. Veshja e jashtme, pas termotkurjes, duhet të jetë e qëndrueshme ndaj goditjeve mekanike dhe agjenteve atmosferike, të mos ndikohet nga mjediset kimike, acide apo bazike, të ketë qëndrueshmëri të lartë ndaj rezatimit ultraviolet, për të mos lejuar vjetërim të shpejtë të materialit.

Bashkueset metalike (gizat me bulon) duhet të jenë pjesë e setit. Ato duhet të jenë të pershtateshme për të realizuar bashkimin e përcjellesave alumini ose bakër.

#### Te dhëna teknike

Seksioni I përcjellesit të fazës të kabllit TU (mm <sup>2</sup> )	Dimensionet orientuese të muftës	
	Diametri (mm)	Gjatesia (mm)
10 – 35	50	450
25 - 70	70	600
70 – 120	80	650
150 - 240	110	800

#### 5. Përdorimi

Muftet janë ndërtuar për tu përdorur në kabllot e TU me 4 deje.

#### 6. Vendet e përdorimit

Muftet TU duhet të përdoren në të gjithë territorin

#### 7. Standartet referuese

Muftet TU me termo-tkurje duhet të prodhohen conform standarteve të mëposhtme:

IEC 60502, IEC 60331, DIN EN 50393, VDE 0278 pjesa 393, ose standartet e tjera ekuivalente.

#### 8. Paketimi

Paketimi duhet të jetë i projektuar në mënyrë të tillë që të mbrojë mallin nga hyrja e ujit dhe demtimet mekanike. Të gjitha pjesët perberëse duhet të ruajnë parametrat teknike në temperaturat -5°C deri 40 °C. Çdo muftë duhet të ketë brenda ambalazhimit udhëzimet e instalimit, aplikimin, diapazonin e përdorimit si dhe emërtimin dhe sasinë e pjesëve perberëse. Emërtimet, diapazoni, emri i firmës prodhuese duhet të jetë i stamposur mbi çdo pjesë perberëse.

Në secilin paketim duhet të shënohet:

- Emri i prodhuesit
- Numri i kontrates
- Numri i urdherit të blerjes
- Seksioni (mm<sup>2</sup>)
- Numri, seksioni terthor dhe diametri i përcjellesve dhe i kabllit
- tensioni izolimit (1000 V)
- lloji I materialit izolues
- standartet referuese
- Pesha (kg)

## 9. Testet

Te gjitha testet duhet te kryhen ne perputhje me DIN EN 50393, VDE 0278 part 393 ose standartet e tyre ekuivalente.

Date, seal and Signature of Tenderer:

### Tabela e te dhenave (DATA SCHEDULES)

ITEM	Pershkrimi (DESCRIPTION)	Njesia (UNIT)	Kerkesa (required)	Funk. E garantuara (func. Guarantee)
<b>I</b>	<b>Muftë TU me termotkurje (LV Heat Shrinkable Joint)</b>			
<b>1</b>	<b>Te dhena te pergjitheshme (GENERAL DATA)</b>			
1.1	Standarti aplikuar (Applied standard)			
1.2	Prodhuesi (Manufacturer)			
1.3	Tipi muftes (Joint type)			
1.4	Seksioni per te cilin perdoret (Cross section of the joint)	mm <sup>2</sup>	as per request	
1.5	Diametric seksionit (Diameter of the joint)	mm <sup>2</sup>		
1.6	Gjatesia e muftes (Length of the joint)	mm		
1.7	Tipi gilzes (Type of the connector)			
1.8	Materiali gilzes (Material of the connector)		as per request	
1.9	Diametric gilzes (Diameter of the connector)	mm		
1.10	Gjatesia e gilzes (Length of the connector)	mm		



# **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

## **MUFTE NJE FAZORE PER KABLLO TE TM 20 KV**

## MUFTET PER KABLLO NJE FAZORE TE TM 20 KV

### 1.1 Te pergjitheshme

Te gjitha muftet 20 kV jane projektuar qe te jene te sigurt ne kushte klimatike te ndryshme pa pesuar demtime, duke ruajtur strukturen, ndertimin elektrik dhe mekanik te vete kabllit.

Muftet 20 kV duhet te jene te sigurta edhe kur jane ne ngarkese , nen tension apo nen veprimin e lidhjes se shkurter apo avarive te tjera qe mund te ndodhin ne sistem, ato duhet te sigurojne dhe punojne ne kushte optimale

### Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensioned jane orientuese)



### 1.2 Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje:

- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001 ose ISO 9002
- Te dhenat teknike sic kerkohen ne specifikime teknike
- Te gjitha test raportet e fabrikes
- Skicat me dimensione
- Manual perdorimi
- Te kene marketim CE

### 1.3 Kushtet e sistemit

#### Te dhena per sistemin

Specifikime	Njesia	Sistemi 20 kV
Tensioni nominal ne sistem	kV	20
Tensioni me i larte per paisjet	kV	24
Frekuenca e sistemit	Hz	50
Numri I fazeve		3
Sistemi I tokezimit		e izoluar

### Kushtet atmosferike

Temperatura maks. e ambientit	40 °C
Temperatura maks. mesatare ditore	30 °C
Temperatura minimale e ambientit	-10 °C
Temperatura maks. në sipërfaqet e ekspozuara në diell	60 °C
Lageshtia relative maks (në tokë)	95 %
Lageshtia relative maks (në ajër)	80 %
Lartësia maksimale mbi nivelin e detit	<1000 m

Testet fizike dhe elektrike duhet të jenë në përputhje me standartet IEC ose ekuivalentet e tyre. Materialet duhet të jenë sipas standartit ISO 9001 ose një standart më i avancuar.

## 1.4 Përshkrim, kërkesa dhe të dhëna

### A. MUFTE PËR KABLOT NJE DEJESH, TË EKTRANIZUAR, ME IZOLIM POLIMERIK

#### Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet janë orientuese)



Muftet duhet të ruajnë dhe sigurojnë strukturën normale të vetë kabllit ku përdoren.

Muftet e TM për kabell me një dell,  $1x - -mm^2$ , duhet të jenë me material termotkurres.

Ekranin me rrjete bakri, i cili aplikohet mbi trupin e muftës, duhet të jetë i dimensionuar në mënyrë të mjaftueshme që të lejojë të kalojnë nepermjet muftës rrymat e plota të lidhjes me token të sistemit.

Lidhja elektrike e ekranit metalik të kabllit bëhet me lidhës (gilze) në rastin e ekranit me përcjellës bakri, ndërsa në rastin e ekranit me shirit bakri me thurrje bakri, me susta dredhese. Të dyja duhet të jenë në kompletin e muftës.

Zona e xhuntimit të dellit mbulohet me tubin për uniformizimin e fushës elektrike, ndërsa mbi të vendoset tubi i termotkurshëm me parete dyfishe që siguron edhe izolimin e kërkuar edhe ekranin e izolimit.

Dejet duhet të bashkohen me anën e gilzës me bullon që gjendet brenda setit.

Gilzat duhet të jenë në përputhje me standartin ndërkombëtar IEC-61238-1.

Në komplet duhet të përfshihet edhe lidhja me token pa saldim.

Në komplet është edhe rrjeta metalike mbrojtëse.

Hermetizimi dhe qëndrueshmëria mekanike e jashtme e muftës realizohet me një tub të termotkurshëm me parete të trasha dhe i veshur me ngjites të termoshkrishëm, i cili gjatë nxehjes shkrin dhe ngjitet me sipërfaqen e jashtme të kabllit. Ky tub duhet të ketë qëndrueshmëri të mjaftueshme për t'i qëndruar veprimtari të peshave të mprehta dhe duhet të jetë rezistent për kundërshtimet e ujit dhe rrezeve ultraviolette.

Seti i muftëve të furnizuara duhet të përmbajë të gjitha materialet dhe komponentet e nevojshme për montimin e tyre në të gjithë kabllin.

Muftet duhet të jenë dimensionuar në mënyrë të tillë që të lejojnë kushte të përshtatshme instalimi

**Te dhëna teknike të muftëve për kabllë 1x-----mm<sup>2</sup>**

Tensioni i rrjetit (kV)	Seksioni i përcjellesit të fazës së kabllit (mm <sup>2</sup> )
24	25-70
	70-150
	120-240
	95-240

**1.5 Aplikimi**

Muftet duhet të përdoren për kabllë me përcjelles alumini ose bakri me izolim XLPE me një ose trefazë, deri 35 kV.

Muftet janë të ndërtuara për kabllë nëntokesore, në kanalinat e kabllëve ose në ajër.

**1.6 Standartet referuese**

Muftet 10, 20, 35 kV një dhe tre fazore duhet të jenë konform kërkesave të standarteve CENELEC HD 629.1 S1, ose ekuivalentet e tyre.

**1.7 Testet**

Testet duhet të kryhen konform standartit CENELEC Standard HD 629.1 S1

Muftet janë testuar dhe aprovuar në përputhje me standartet ndërkombëtare.

**1.8 Identifikimi dhe paketimi**

Paketimi duhet të jetë i projektuar në mënyrë të tillë që të mbrojë mallin nga hyrja e ujit dhe demtimet mekanike. Të gjitha pjesët përberëse duhet të ruajnë parametrat teknike në temperaturat -5°C deri 40 °C. Çdo muftë duhet të ketë brenda ambalazhimit udhëzimet e instalimit, aplikimin, diapazonin e përdorimit si dhe emërtimin dhe sasinë e pjesëve përberëse. Emërtimet, diapazoni, emri i firmës prodhuese duhet të jetë i stamposur mbi çdo pjesë përberëse.

<b>Tabela e të dhënave</b>				
<b>NR</b>	<b>PERSHKRIMI</b>	<b>NJESIA</b>	<b>kerkesa</b>	<b>Funk.e garantuara</b>



<b>I</b>	<b>MUFTET ME TERMOTKURJE TE TM</b>			
<b>1</b>	<b>TE DHENA TE PERGJITHESHME</b>			
1.1	Standarti i aplikuar			
1.2	Prodhuesi			
1.3	Tipi i muftes			
1.4	Tesioni i rretit	kV	Sipas kerkeses	
1.5	Numri i dejeve	cop	Sipas kerkeses	
1.6	Seksioni per te cilin perdoret	mm <sup>2</sup>	Sipas kerkeses	
1.7	Diametri i seksionit	mm		
1.8	Gjatesia e muftes	mm		
1.9	Tipi i gilzes			
1.10	Material ii gilzes		Sipas kerkeses	
1.11	Seksioni per te cilin perdoret	mm <sup>2</sup>		
1.12	Gjatesia e gilzes	mm		
1.13	Diametri i jashtem i gilzes	mm		

# **SPECIFIKIME TEKNIKE**

## **PAISJE E MATERIALE PER KABINA ME CELA TIP MODUL**

## I. SEKSIONI TM

### TE PERGJITHSHME

Kerkesat specifike per tu aplikuar ne paisje te ndryshme duhet te permbushin Standartet IEC publikimet e fundit ose ekuivalentet e tyre.

Vetem materialet me cilesi te larte do te furnizohen per te gjitha paisjet dhe materialet.

Keto paisje duhet te sigurohen me nje pllakate ne perputhje me standartet IEC.

Te gjitha paisjet duhet te ndertohen sipas kerkesave:

- Te jete ne gjendje te duroje te gjitha kushtet e ngarkeses dhe tensionit.
- E pershtatshme per instalim te brendeshem ne kushte klimatike si me poshte te permendura.
- Lehtesisht e zevendesueshme

Kushtet e sistemit:

Specifikimet	Njesia	Sistemi 20 kV	Sistemi 0.4 kV
Te dhena per sistemin			
Tensioni me I larte I sistemit	kV	24	0.66
Tensioni nominal	kV	20	0.4 / 0.23
Frekuenca	Hz	50	50
Numri I fazeve	Nr	3	3 faze/4 percjelles
Sistemi I tokezimit	-	I izoluar	Direkt ne toke
Rryma ne lidhje te shkurter	kA	20	20

Kushtet atmosferike:

Temperatura maksimale e ambientit	+ 40 °C
Temperature minimale e ambientit	- 10 °C
Temperatura mesatare maksimale ditore	+ 30 °C
Lageshtia relative maksimale	80 %
Lartesia maksimale mbi nivelin e detit	1000 m

Testet fizike dhe elektrike te pranimit do te behen ne perputhje me standartet IEC.

## A. CELA TM 20 KV TIP MODUL PER KABINA ME NDARES ME IZOLACION SF6

### 1. KERKESA TE PERGJITHSHME

#### Ilustrimi

(Ilustrimi dhe dimensioned jane orienruese)



#### 1.1 SHTRIRJA E FURNIZIMEVE DHE SHERBIMEVE

Ky specifikim perfshin projektimin, prodhimin, testimin dhe transportin ne magazine te paisjeve elektromekanike te meposhtme.

1	CELA TM
1.1	Cela e linjes me ndares ngarkese me gaz SF6 Cela permban ndaresin me gaz SF6, thiken e tokezimit, percjellesit dhe zbarat lidhese; zbarat e daljes se TM te sheshta te pershtateshme per lidhjen e kapikordes te kablllove nje dejesh
1.2	Cela e trasformatorit me ndares ngarkese me gaz SF6 dhe sigurese. Cela permban ndaresin e ngarkeses me izolacion me gaz SF6, thiken e tokezimit, siguresat, percjellesit dhe zbarat lidhese; zbarat e daljes se TM te sheshta te pershtateshme per lidhjen e kapikordes te kablllove nje dejesh

Pjese integrale e furnizimit jane te gjitha skemat dhe diagramat, , po ashtu edhe instruksionet e mirembajtjes dhe te perdorimit.

Te gjitha furnizimet duhet te jene sipas specifikimeve teknike.

#### 1.2 Njesite e matjes

Ne te gjitha dokumentat, si korespodencat, listen teknike, skemat, njesite matese duhet te jene te sistemit metrik.

#### 1.3 Standartet

Projektimi , materialet dhe testimi sipas kesaj kontrate duhet te plotesoje standartet IEC te permendura ne Specifikimet teknike te detajuara.

Materialet fiksuese, si bullona, dado, rondele, vida duhet te jene sipas standartit DIN.

Materialet duhet të jenë të reja dhe të cilësisë së parë, të përshtatshme për këtë qëllim, dhe të klasifikimit dhe klases së cilësisë sipas botimeve më të fundit të ASTM ose standartit DIN.

#### **1.4     Kontrolle dhe testet e fabrikës**

Testet duhet të bëhen në një laborator të certifikuar, në fabrikë ose në një laborator të pa varur. Rezultatet e të gjitha testeve duhet të regjistrohen në raportin e testit ku të shprehen të dhëna specifike në vlera.

#### **1.5     Shërbime të nevojshme**

Furnizuesi duhet të sigurojë shërbimet e mëposhtme:

- Furnizimin e paisjeve të kërkuara për montimin ose mirëmbajtjen e materialeve të furnizuara;
- Furnizimin e manualeve të përdorimit dhe mirëmbajtjes dhe dokumenta të tjera të specifikuar në Specifikime Teknike.
- Trainimin e personelit në fabrikën e furnizuesit ose në rrjet për montim, fillim, përdorim dhe mirëmbajtje dhe/ose riparimin e materialeve të furnizuara.

#### **1.6     Informacioni që duhet të paraqitet nga furnizuesi**

Ceshtjet e mëposhtme specifikojnë informacionin e kërkuar nga furnizuesi gjatë periudhës së kontratës, aprovimi I skemave, gjuha, dhe procedura për dërgimin e dokumentave përfshirë “as built” dokumenta.

##### **1.6.1    Te përgjithshme**

Furnizuesi duhet të paraqes të bleresi:

Vizatimet , të dhënat e projektimit, përshkrimet e paisjeve, llogaritjet, raportet e testeve, instruksionet e instalimit dhe të mirëmbajtjes. Sekuenca e dorëzimit do të jetë e tillë që informacioni është në dispozicion për miratimin në kohë të çdo dokumenti, kur ajo është e pranuar.

Skemat e furnizuesit, të dhënat e projektimit dhe llogaritjet të paraqitura formalisht duhet të jepen zyrtarisht nga furnizuesi të kontrolluara nëse janë korrekt për përdorim në punë.

Dokumentacioni “as built”(skemat, test raportet, instruksionet e përdorimit dhe mirëmbajtjes) duhet të vendosen në mënyrë të rregullt në foldera.

##### **1.6.2    Informacioni I kërkuar**

###### Skicat

Skemat e paisjeve që tregojnë dimensionet e përgjithshme me distancat minimum të kërkuara në lidhje me paisjet e afërta, peshat, hapësirat e punës, detajet e lidhjeve dhe instalimeve.

###### Skemat

Skemat e zakonshme te montimit. Keto skema duhet te tregojne ne shkalle reale te gjithe komponentet perberes te paisjeve dhe komponentet duhet te identifikohen ne formen e legjendes.

#### Ilogaritjet/kriteret e projektimit

Furnizuesi duhet te siguroje karakteristikat e komutimit per siguresat TM dhe automatet.

#### Raportet e testeve

Per testet e kerkuara ne Specifikimet teknike te detajuara

#### Instruksione per kolaudimin dhe instalimin

I gjithe informacioni I nevojshem per te lejuar instalimin dhe kolaudimin nga bleresi.

#### Instruksione perdorimi dhe mirembajtje

Udhezimet e detajuara dhe te plotesuara te perdorimit dhe mirembajtjes per paisjet dhe ndonje paisje apo instrument I vecante e cila eshte pjese e kontrates.

#### "As Built" Documentation

The "as built" documentation perfshin:

- Skicat
- Skemat e montimit
- Raportet e testeve
- Udhezime te instalimit dhe kolaudimit
- Udhezime perdorimi dhe mirembajtje

Te gjitha te perditesuara me modifikimete bere me pranimin e furnizuesit.

## **1.7 Aprovimi I dokumentave, Formati dhe numrat e paraqitura**

### **1.7.1 Te pergjithshme**

I gjithe dokumentacioni duhet te mblidhet ne nje madhesi sipas DIN 476,seria A preferuar ne A4(297 x 210 mm).

Madhesite e skemave duhet te plotesohen me ISO seria A: Madhesia normale ne minimum A4 (297 x 210 mm) dhe maksimumi AO (1,189 x 841 mm).

Dokumenta per tu aprovuar nga bleresi:

Nje kopje(nga 3 te paraqitura) Do te rikthehen tek furnizuesi shenuar “aprovuar” “aprovuar me shenime”ose “rikthim per korrektime”. Shenimi I printuar”Aprovuar” dhe “Aprovuar me shenime” autorizon furnizuesin per te proceduar me fabrikimin e paisjes. Nese pas dorezimit te sa me siper, kontraktuesi ka korigjime te tjera te vogla, ai ja dergon ato sa me shpejt furnizuesit me shkrim. Ne asnje rast furnizuesi nuk eshte I cliruar nga pergjegjesite ne perputhje me kontraten.

### **1.7.2 Gjuha**

Te gjitha skemat, shkurtime e katalogeve, specifikimet e printuara, dhe instruksionet duhet te jene ne anglisht. Megjithate te gjitha tabelat qe tregojne sigurine apo informacione per perdorimin duhet te jene ne gjuhen shqipe.

## 2. Specifikime teknike te detajuara

### 2.1 Te pergjithshme

Ky specifikim permban Specifikimet Teknike te Pergjitheshme per projektimin, prodhimin, testimin e paisjeve per perdorim te brendshem me lidhje kablli nga poshte si dhe furnizimin e paisjes.

Kerkesat specifike per tu aplikuar ne paisje te ndryshme duhet te permbushin Standartet IEC publikimet e fundit ose ekuivalentet e tyre.

Celat 20 kV do te perdoren ne rrjetin e shperndarjes. Vetem materialet me cilesi te larte do te furnizohen.

Keto paisje do te montohen ne Stacionet e Transformimit(kabinat) 20/0.4 kV dhe duhet te sigurohen me nje pllakate(targete) ne perputhje me standartet IEC.

Te gjitha paisjet duhet te ndertohen sipas kerkesave:

- Te jete ne gjendje te duroje te gjitha kushtet e ngarkeses dhe tensionit.
- E pershtatshme per instalim te brendeshem ne kushte klimatike si me poshte te permendura.
- Lehtesisht e zevendesueshme
- Te kene markim CE

Kushtet e sistemit

Specifikime	Njesia	Sistemi 20 kV
Te dhena per sistemin		
Tensioni me I larte I sistemit	kV	24
Tensioni nominal	kV	20
Frekuenca	Hz	50
Numri I fazeve	No.	3
Sistemi I tokezimit	-	I izoluar
Lloji I nenstacionit		I brendshem
Rryma e lidhjes shkurter 1 sek	kA	20

Kushtet atmosferike

Temperatura maksimale e ambientit	+ 40 °C
Temperature minimale e ambientit	- 10 °C
Temperatura mesatare maksimale ditore	+ 30 °C
Lageshtia relative maksimale	80 %
Lartesia maksimale mbi nivelin e detit	1000 m

Testet fizike dhe elektrike te pranimit do te behen ne perputhje me standartet IEC.



## 2.2 Cela 20 kV tip modul(cubicle)

**Cela e linjes hyrese/dalese me ndares ngarkese me gaz SF6 dhe cela e mbrojtjes te trasformatorit me ndares ngarkese me gaz SF6 dhe siguresse TM**

### 2.2.1 Pershkrime, kerkesa dhe te dhena

Te gjitha paisjet e kesaj pjese do te montohen ne boks metalik :

- Cela e linjes me ndares ngarkese me gaz SF6 permban ndaresin e ngarkeses me gaz SF6, thiken e tokezimit, percjellesit dhe zbarat lidhese; zbarat e daljes se TM te sheshta te pershtateshme per lidhjen e kapikordes te kablllove nje dejesh.
- Cela e trasformatorit me ndares ngarkese me gaz SF6 dhe siguresse. Cela permban ndaresin e ngarkeses me gaz SF6, thiken e tokezimit, siguresat, percjellesit dhe zbarat lidhese; zbarat e daljes se TM te sheshta te pershtateshme per lidhjen e kapikordes te kablllove nje dejesh

### 2.2.2 Cele linje me ndares ngarkese me SF6(panel with SF6 load switch disconnecter)

#### TE DHENA TEKNIKE

Tensioni me I larte I sistemit	kV	24
Vlera e tensionit nominal	kV	20
Rryma nominale ne zbare	A	630
Rryma nominale ne fider	A	630
Rryma nominale ne lidhje te shkurter (1 sec.)	kA	20
Vlera e tensionit impulsiv te qendrueshmerise ndaj shkarkimeve	kV	125
Vlera e tensionit te qendrueshmerise per frekuencen 50 Hz	kV	50
Shkalla e mbrojtjes		IP 3X

Permasat orientuese jane:

Lartesia	mm	2200 max
Thellesia	mm	1100 max
Gjeresia	mm	600 max

#### **Ndertimi dhe materiali**

Paneli do të ketë një shkallë mbrojtjeje të përgjithshme IP 3X.

Të gjitha pjesët e çelikut do të trajtohen me proces pastrimi, heqjeje të grasos dhe fosfatimi.

Pjeset perberese do të ndërtohen me fletë çeliku te galvanizuar dhe te perforuar, që të jenë të sigurt dhe të mos deformohen edhe në kushtet më të vështira të punës.

Në pjesen fundore paneli duhet te pajiset me korniza për tu fiksuar në dyshemenë prej betoni.

Panelet do të pajisen me dritare ne pjesen e perparme për të monitoruar pozicionin e kontakteve te ndaresit te ngarkesës dhe thikës se tokës si dhe çdo të dhënë të rëndësishme.

Siguria e personelit do të garantohet me kycje të thjeshtë manuale që parandalon çdo mundësi përdorimi të gabuar. Dera eshte e nderthurur me bllokim mekanik me thiken e tokes.

Klasifikimi i Harkut te brendshem do te jete IAC AFLR 12.5 kA 1sekond. Pershkrimi I mbrojtjes si standartit nderkombetar.

Sistemi i zbarave do të montohet në ndarjen e duhur te panelit, në mënyrë që të bëhet e mundur lidhja e duhur e të gjitha pajisjeve ndërmjet terminaleve te kablllove hyrës dhe dalës.

Sistemi i zbarave do të dimensionohet, rregullohet dhe të fiksohet në atë mënyrë që t'i rezistojë dinamikës së pikut të rrymës te lidhjes të shkurtër, pa transmetuar tension shtesë ne izolatorët dhe pjesët e tjera të panelit.

Indikatorët e tensionit për çdo faze, duhet te jene tregues kapacitive.

Per te shmangur kondesimin paneli duhet te jete i paisur me sistem antikondesimi me element ngrohes rezistence elektrike me tension 230 V per te parandaluar shfaqjen e lageshtires ne kasete.

Cela duhet te jete e paisur me aparat(manometer) me sinjalizim visual per presionin e lejuar te gazit. Ajo duhet te kete nje tregues me ngjyra ku ngjyra jeshile te tregoje se paisja eshte ne gjendje per te operuar dhe ngjyra e kuqe te tregoje se paisja nuk duhet te operoje.

Paneli metalik duhet te jete me etiketë(targete), në përputhje me Standardin IEC 62271.

Dyert e panelit duhet te jene paisura me sistem bllokazhi me qellim qe te mos hapen pa u mare te gjitha masat e sigurise si heqje tensioni, tokezim e tje.

Çdo panel do të jetë i llojit vetë mbështetës, i pa integruar (i veçuar), që të ofrojë lehtësisht akses për punë, inspektim dhe mirëmbajtje nga ana ballore.

Të gjitha materialet për të fiksuar panelin në dyshemenë prej betoni do të konsiderohen si të përfshira në furnizim.

Paneli duhet te ofroje mundesi zgjerimi ne te dy krahet dhe te pershtatet ne lidhje edhe me tipet e moduleve egzistuese.

Ndaresit do të jenë të llojit “me veprim te shpejte”(suste me mekanizem karikimi) me pjesë të dimensionuara lirshëm.

Komutimi i ndaresit te ngarkeses behet ne menyre manuale. Pjese e furnizimit do te jete edhe leva per manovrimin e ndaresit dhe thikes se tokes.

Ndaresi duhet te jete me tre pozicione.

Kontaktet do të jenë të mbuluara me një shtresë argjendi ose të kenë një mbrojtje ekuivalente.

Për arsye sigurie, duhet një indikator tregues për pozicionin e ndaresit të ngarkesës dhe thikës së tokëzimit.

Ndaresi i ngarkesës dhe thika e tokëzimit kanë bllokim mekanik midis tyre.

### 2.2.3 Cele transformatori (cubicle) me ndares ngarkese me SF6 dhe sigures (panel with SF6 load switch disconnector and fuses)

#### Pershkrim, Kerkesa dhe te Dhena

Ky specifikim mbulon kerkesat per celat TM me ndares ngarkese dhe sigures.

Ndaresi I ngarkesës, duhet të përballojë dhe ndërprejë çdo rrymë nga zero deri në rrymën nominale të tensionit të mesëm të sistemit (20 kV).

#### TE DHENA TEKNIKE

Nr	Lloji	Celeri I ngarkesës trepolare	
1	Tensioni me I larte I sistemit	kV	24
2	Tensioni nominal	kV	20
3	Rryma nominale ne zbare	A	630
4	Rryma nominale e ndaresit ( $I_n$ )	A	200
5	Frekuenca	Hz	50
6	Rryma qe duron ne qark te shkurter per 1 sec.	kA	20
7	Vlera e tensionit impulsiv te qendrueshmerise ndaj shkarkimeve	kV	125
8	Vlera e tensionit te qendrueshmerise per frekuencen 50 Hz	kV	50

Permasat orientuese jane

Lartesia	mm	2200 max
Thellesia	mm	1100 max
Gjeresia	mm	600 max

#### Ndertimi dhe materiali

Paneli do të ketë një shkallë mbrojtjeje të përgjithshme IP 3X.

Të gjitha pjesët e çelikut do të trajtohen me proces pastrimi, heqjeje të grasos dhe fosfatimi. Pjesët perberese do të ndërtohen me fletë çeliku të galvanizuar dhe të përforcuar, që të jenë të sigurtat dhe të mos deformohen edhe në kushtet më të vështira të punës.

Në pjesën fundore paneli duhet të pajiset me korniza për tu fiksuar në dyshtemenë prej betoni.

Panelet do të pajisen me dritare ne pjesen e perparme për të monitoruar pozicionin e kontakteve te ndaresit te ngarkesës dhe thikës se tokës si dhe çdo të dhënë të rëndësishme.

Siguria e personelit do të garantohet me kycje të thjeshtë manuale që parandalon çdo mundësi përdorimi të gabuar. Dera eshte e nderthurur me bllokim mekanik me thiken e tokes.

Klasifikimi i Harkut te brendshem do te jete IAC AFLR 12.5 kA 1sekond. Pershkrimi I mbrojtjes si standartit nderkombetar.

Klasa e operimit LSC2A

Sistemi i zbarave do të montohet në ndarjen e duhur te panelit, në mënyrë që të bëhet e mundur lidhja e duhur e të gjitha pajisjeve ndërmjet terminaleve te kablllove hyrës dhe dalës.

Sistemi i zbarave do të dimensionohet, rregullohet dhe të fiksohet në atë mënyrë që t'i rezistojë dinamikës së pikut të rrymës te lidhjes të shkurtër, pa transmetuar tension shtesë ne izolatorët dhe pjesët e tjera të panelit.

Indikatorët e tensionit për çdo faze, duhet te jene tregues kapacitive.

Per te shmangur kondesimin paneli duhet te jete i paisur me sistem antikondesimi me element ngrohes rezistence elektrike me tension 230 V per te parandaluar shfaqjen e lageshtires ne kasete.

Cela duhet te jete e paisur me aparat(manometer) me sinjalizim visual per presionin e lejuar te gazit. Ajo duhet te kete nje tregues me ngjyra ku ngjyra jeshile te tregoje se paisja eshte ne gjendje per te operuar dhe ngjyra e kuqe te tregoje se paisja nuk duhet te operoje.

Paneli metalik duhet te jete me etiketë(targete), në përputhje me Standardin IEC 62271.

Dyert e panelit duhet te jene paisura me sistem bllokazhi me qellim qe te mos hapen pa u mare te gjitha masat e sigurise si heqje tensioni, tokezim e tje.

Çdo panel do të jetë i llojit vetë mbështetës, i pa integruar (i veçuar), që të ofrojë lehtësisht akses për punë, inspektim dhe mirëmbajtje nga ana ballore.

Të gjitha materialet për të fiksuar panelin në dyshemenë prej betoni do të konsiderohen si të përfshira në furnizim.

Paneli duhet te ofroje mundesi zgjerimi ne te dy krahet dhe te pershtatet ne lidhje edhe me tipet e moduleve egzistuese.

Ndaresit do të jenë të llojit “me veprim te shpejte”(suste me mekanizem karikimi) me pjesë të dimensionuara lirshëm.

Komutimi i ndaresit te ngarkeses behet ne menyre manuale. Pjese e furnizimit do te jete edhe leva per manovrimin e ndaresit dhe thikes se tokes.

Ndaresi duhet te jete me tre pozicione.

Kontaktet do të jenë të mbuluara me një shtresë argjendi ose të kenë një mbrojtje ekuivalente.

Për arsye sigurie, duhet një indikator tregues per pozicionin e ndaresit te ngarkesës dhe thikes se tokëzimit.

Ndaresi i ngarkeses dhe thika e tokezimit kane bllokim mekanik midis tyre.

Djegja e sigureses duhet te shoqerohet me stakimin e ndaresit.

### Siguresat TM

Ky specifikim mbulon kërkesat e siguresave TM, të përshtatshme për instalime të brendshme.

#### TE DHENA TEKNIKE

1	Tensioni nominal	20 kV
2	Tensioni me I larte I sistemit	24 kV
3	Numri I fazeve	3
4	Frekuenca nominale	50 Hz
5	Rryma nominale ( $I_n$ ) per TR 400KVA	25 A
6	Rryma ne lidhje te shkurter per 1 sec.	20 kA
7	Rryma maksimale qe percjell (piku)	3 kA
8	Tensioni qe duron ndaj shkarkimeve ne 1.2 / 50 ms	125 kV
9	Tensioni qe duron ne frekuence te fuqise	50 kV

Rryma nominale e fillit shkrires te sigureses per trasformatoret e shperndarjes zgjidhet sipas tabelës së më poshtme:

Vlera nominale e tensionit ne siguresë dhe transformator (kV)	Fuqia e transformatorit (kVA)					
	50	100	160	250	400	630
	Rryma nominale e fishekut te siguresë (A)					
6	16	25	31.5	50	63	100
10	10	16	25	31.5	50	63
20	10	10	16	20	25	40
35	10	10	10	10	16	25

Tabela është llogaritur sipas standarteve IEC 60282-1 dhe IEC 62271-105, DIN 43625 . Kushtet e punës së transformatoreve janë supozuar si më poshtë.

- Rryma e thithjes e manjetizimit –  $12 \times I_n$  gjatë 100 ms,
- tensioni I lidhjes së shkurter të transformatorit sipas IEC 60076-5,
- kushtet standarte të ambientit të punës së sigureses

Rryma nominale e fishekut te sigureses zgjidhet ne funksion te fuqise se transformatorit. Kjo specifikohet ne kerkesa. Furnizuesi ne cdo rast duhet te percaktoje me bleresin fuqine e transformatorit dhe ne funksion te saj rymen nominale te sigureses.

#### Ndertimi dhe materiali

Siguresat TM do të kenë aftësinë të mbrojnë transformatorin e fuqisë nga rrymat e lidhjes së shkurter.

Siguresat TM do të kenë ndërtim të tilla që të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

- Qendrushmeri ndaj të rrymave në lidhje të shkurtër
- Qendrushmeri të mjaftueshme ndaj kushteve të ambientit
- Pjesët perberese të sigureses të mos vjeterohen shpejt

- Të bëhet e mundur ndërrimi i tyre me siguresa të prodhuara sipas nje standarti nderkombetar.

Furnizuesi duhet te paraqese karakteristiken rrymë-kohe, që tregon vartesine midis rrymes qe kalon ne siguresa dhe kohes gjate te ciles siguresa nderpritet (vepron) dhe është e domosdoshme që filli shkrires të mos shkrijë per një ore prej një rryme prej 130 % të vlerës nominale. Per rryma 200% të vlerës nominale, shkrija duhet të ndodhë brenda një intervali kohor në më pak se një orë.

Fisheku do të prodhohet prej porcelani cilësor me sipërfaqe të shkëlqyeshme.

Të dyja pjeset e kontaktit te fishekut(xokolat), e poshtmjia edhe e sipërmja, do të realizohen me material bakri elektrolitit i mbrojtur galvanikisht, te rotulluara ne kanal in e tubit te sigureses ne menyre hermetike. Kjo eshte shume e rendesishme sepse hermetizimi I ketij bashkimi eshte rezistent ndaj konsumit(vjeterimit) dhe temperaturave te larta.

Komponent shume I rendesishem I siguresave TM eshte elementi shkrires , percjellesat ose shiritat duhet te jene argjend I paster. Preferohet te kete sa me shume elemente shkrires te lidhur ne parallel , me qellim qe te arrihet trashesi sa me vogel e tyre.

Siguresa do te lidhet me nje paisje sinjalizuese, e cila do te jap informacion mbi gjendjen e sigureses apo mekanizmave te tjere si p.sh ndaresin e ngarkeses. Djegja e sigureses duhet te shoqerohet me stakimin e ndaresit.

Izolatorët mbështetës të bazamentit duhet të prodhohen prej porcelani ose epoxy material.

Fashetat (fiksuesit) , te cilat bejne kontaktin elektrik me xokolat e sigureses duhet te realizohen me baker elektrolitik te zinkuar, fashetat duhet te kene elasticitet te larte mekanik me qellim qe te sigurojne vlere te vogel te rezistences se kontaktit.

Pjesa metalike (bazamenti) duhet te jete material çeliku i galvanizuar.

#### 2.2.4 Standartet referuese

Celat duhet te plotesojne standartet me te fundit IEC ose ekuivalentet e tyre.

- IEC 62271 Pajisje komutimi dhe kontrolli për tension të lartë(High-voltage switchgear and controlgear)
- IEC62271-200 Pajisje komutimi dhe kontrolli të tensionit të lartë -Pajisje komutimi dhe kontrolli AC Te asambuara ne kuti metalike për tension të vlerësuar mbi 1 kV deri dhe 52 kV përfshirë (High-voltage switchgear and controlgear - Part 200: AC metal-enclosed switchgear and controlgear for rated voltages above 1 kV and up to and including 52 kV)
- IEC 62271-102 Pajisje komutimi dhe kontrolli për tension të lartë - Pjesa 102 Stakuesit e rrymës alternative me tension të lartë dhe çelësat e tokëzimit(High-voltage switchgear and controlgear - Part 102: Alternating current disconnectors and earthing switches)
- IEC 60282 Siguresat e tensionit të lartë - Pjesa 1: Siguresat me kufizimin e rrymës(High-voltage fuses - Part 1: Current-limiting fuses)
- IEC 62271-105:2012 Pajisje komutimi dhe kontrolli për tension të lartë - Pjesa 105: Kombinimet çelës-siguresë të rrymës alternative për tension të vlerësuar mbi 1 kV deri dhe përfshirë 52 kV(High-voltage switchgear and controlgear - Part 105: Alternating

- current switch-fuse combinations for rated voltages above 1 kV up to and including 52 kV)
- IEC 62271-103 Pajisje komutimi dhe kontrolli për tension të lartë - Pjesa 103: Çelësa për tension të vlerësuar mbi 1 kV deri dhe përfshirë 52 kV(High-voltage switchgear and controlgear - Part 103: Switches for rated voltages above 1 kV up to and including 52 kV)
  - IEC 62271-206 Pajisje komutimi dhe kontrolli për tension të lartë - Sistemet tregues të prezencës së tensionit për tension të vlerësuar mbi 1kV deri dhe duke përfshire 52kV(High-voltage switchgear and controlgear - Part 206: Voltage presence indicating systems for rated voltages above 1 kV and up to and including 52 kV)
  - IEC 62271-210 Pajisje komutimi dhe kontrolli për tension të lartë - Pjesa 210:Kualifikimi sizmik per paisjet e komutimit dhe te kontrollit te asambluara ne kuti metalike dhe izolacoion solid për tension të vlerësuar mbi 1kV deri dhe duke përfshire 52kV(High-voltage switchgear and controlgear - Part 210: Seismic qualification for metal enclosed and solid-insulation enclosed switchgear and controlgear assemblies for rated voltages above 1 kV and up to and including 52 kV)
  - EC 61869-2:2012 Transformatorët matës - Pjesa 2: Kërkesat shtesë për transformatorët e rrymës(Instrument transformers - Part 2: Additional requirements for current transformers)
  - IEC 60529 Shkallet e mbrojtjes te ofruara per paisjet e mbyllura(Kodi IP) (Degrees of protection provided by enclosures (IP code))

## 2.2.5 Testet


### Testet

Testet tip dhe rutine duhet te kryhen nga nje laborator i certifikuar, ne perputhje me standartet IEC 62271-307 ose ekuivalentet e tij.

- \* Testi dielektrik ne qarkun kryesor
- \* Testi shkarkimeve te pjeseshme
- \* Testi I shpejtesise se hapjes dhe mbylljes se ndaresit te linjes, ndaresit te tokes
- \* Testi funksionimit te qarqeve ndihmese
- \* Matja e rezistences ne qarkun kryesor
- \* Testet mekanike dhe dhe impaktet mekanike
- \* Verifikimi I saktetise se instalimeve
- \* Testet e qendrushmerise ndaj rrymave te LSH
- \* Testi ndaj impulsit te shkarkimeve
- \* Verifikimi i shkalles se mbrojtjes
- \* Testi i arkut te brendshem
- \* Testet per kapacitetin kyces dhe ckyces te ndaresit
- \* Temperature rise tests

Blersi rezervon te drejten qe te jete present ne ndonje test qe ai e sheh te arsyeshem.

### Skemat nje vijeshe



## B- TRASFORMATORET E SHPERNDARJES

### 1. KERKESA TE DETYRUESHME

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje te dhena teknike ( pjese e specifikimeve teknike) si pjese integrale e propozimit te tyre.

- Certifikatat e prodhimit ISO 9001
- Te dhena teknike (TDSH) plotesuar sic kerkohen me poshte
- Katalogu I produktit,
- Emri I llojit, vendi I prodhimit
- Pershkrime teknike perfshire edhe parametrat dhe aksesoret e garantuar
- Skemat me dimensione perfshire vendndodhjen dhe pershkrimi I terminaleve te peshtjelles ne mbulesa
- Pershkrimi ne pllakate
- Pesha e vajit
- Jetgjatesia (vite)
